

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5832
E shtunë, 20 korrik 2019
çmimi 0.40 €

Ambasadorët Kosnett dhe O'Connell përkrahin vendimin e KShC-së

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

GJYKATA SPECIALE KA FTUAR PËR INTERVISTIM KRYEMINISTRIN RAMUSH HARADINAJ NË CILËSINË E TË DYSHUARIT

FAQE 4-5

Gjenerali i përgjigjet Speciales për UÇK-në



Ramush Haradinaj ka dhënë dorëheqje të përvokueshme nga posti i kryeministrit të Republikës së Kosovës. Ai ka bërë me dije se arsyeja e kësaj dorëheqje është fresa nga Gjykata Speciale në cilësinë e të dyshuarit. Lajmin e dorëheqjes Haradinaj e ka konfirmuar të premtën në mbledhjen e kabinetit

qeveria e dorëhequr do ta vazhdojë punën deri në formimin e qeverisë së re. Haradinaj i ka bërë thirrje presidentit Thaçi që në afatin kushtetues t'i kryejë konsultimet me partitë politike dhe t'i

qeveritar dhe në një konferencë për medie. Ai ka treguar se

shpallë zgjedhjet e parakohshme. Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se në Hagë do të dalë përballë shpifësve ashtu si e kërkon nderi i luftëtarit shqiptar. Ai ka thënë se pastërtia e tij dhe e luftës së UÇK-së nuk mund të njolloset nga askush dhe asnjëherë



Pse ka skepticizëm te shqiptarët emërimi i Borrellit për shef të diplomacisë evropiane?

FAQE 3

AKTUALE

JUNIKU PROTESTON PËR MBROJTJE TË LUMIT ERENIK

F. 7

GJENERALI I NATO-s INFORMOHET ME PLANIN E TRANZICIONIT TË FSK-së

F. 7

SHALA: EKIPEVE INOVATIVE U DUHEN VEGLA DHE INFRASTRUKTURË PËR T'I TRANSFORMUAR IDETË E TYRE

F. 2

EKONOMI

TË HYRAT E ATK-së SHËNUAN RRRITJE PËR 19.5 MILIONË EURO

F. 8

STUDENTËT E UNIVERSITETIT VEROR NDËRKOMBËTAR TË PRISHTINËS MËSOJNË PËR ROLIN E BQK-së

F. 9



KULTURË

KUR E KALOI KADARE RUBIKONIN E VET?

Bedri ISLAMI



SPORT

STATUJË BRONZI PËR MAJLINDËN, MBËSHKETET VENDIMI I IJF-së

F.20

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Bolton: As Kosova e as Serbia nuk përfitojnë nga 'status quoja'

Uashington, 19 korrik - Këshilltari amerikan për Sigurinë Kombëtare, John Bolton, tha se bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të lëvizin përpara dhe është "koha që të dyja palët të veprojnë menjëherë". Ai i bëri komentet në rrjetin social "Twitter" pas takimit me ministrin e Jashtëm serb Ivica Dačić.


"U pajtuam që bisedimet me Kosovën duhet të lëvizin përpara meqë asnjëra palë nuk fiton nga 'status-quoja'. Koha për të vepruar për të dyja palët është tani", shkroi ai.

Ndërsa ministri serb në një intervistë për programin në gjuhën serbe të "Zërit të Amerikës", thase "gjetja e një zgjidhjeje të qën-

drueshme dhe paqësore për problemin e Kosovës mbetet lart në listën e përparësive të politikës së jashtme të administratës së presidentin amerikan Donald Trump", duke paralajmëruar se muajin e ardhshëm mund të ketë përpjekje të reja amerikane për ta siguruar ripërtëritjen e procesit të pezulluar të bisedimeve ndërmjet

palëve.

Përpjekje të tilla u paralajmëruan gjatë kësaj jave edhe nga presidenti francez Emmanuel Macron gjatë një vizite në Beograd, pas së cilës u tha se shtatori mund të jetë periudhë kur ai do t'i ftojë në Paris udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë, bashkë me kancelaren gjermane Angela Merkel.



Leyen mbështet hapjen e negociatave me Shqipërinë

"Ne duhet t'ua japim dorën Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore meqë ne ndajmë të njëjtin kontinent, të njëjtën histori, jemi fqinjë dhe, nëse e mbyllim derën për këtë rajon, dëmtojmë vetveten", tha presidentja e sapozgjedhur e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen



Rinne i tha gjithashtu Parlamentit Evropian se vendi i tij do t'i vazhdonte negociatat edhe për një sërë çështjesh të tjera të unionit.

Rinne paraqiti katër prioritetet e presidencës finlandeze që janë forcimi i BE-së si lider global në çështjen e klimës, forcimi i vlerave të përbashkëta dhe sundimi i ligjit, forcimi i konkurrencës së unionit dhe mbrojtja e sigurisë së qytetarëve. "Duke u mbështetur në faktet më të rëndësishme, është e nevojshme që Bashkimi Evropian t'u përgjigjet pyetjeve të qytetarëve të tij. Këto përgjigje duhet të jepen njëzëri nga unioni dhe jo nga shtete të veçanta", theksoi Rinne. "Kjo është arsyeja që ne i morëm në konsideratë këto çështje në programin tonë", tha kryeministri finlandez Antti Rinne.

BERLIN, 19 KORRIK - Presidentja e re e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, e cila u zgjodh nga Parlamenti Evropian të martën, mbështet një perspektivë të shpejtë të pranimit për Shqipërinë dhe Maqedoninë Veriore. "Ne duhet t'i hapim negociatat e pranimit me vendet sapo Këshilli Evropian të arrijë në përfundimin se kriteret janë përmbushur", theksoi ajo për gazetën gjermane "Spiegel". "Ne duhet t'ua japim dorën Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore meqë ne ndajmë të


njëjtin kontinent, të njëjtën histori, jemi fqinjë dhe, nëse e mbyllim derën për këtë rajon, dëmtojmë vetveten", shtoi ajo. Gazeta shkruan se BE-ja ua ka ofruar disa vendeve të Ballkanit Perëndimor perspektivat e pranimit për vitin 2025, por ka shtyrë kohët e fundit fillimin e negociatave për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë.

Ndërkaq kryeministri finlandez Antti Rinne deklaroi në Parlamentin Evropian se presidentja finlandeze e radhës e Bashkimit Evropian shpresonte

që Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut t'i hapnin në tetor negociatat e anëtarësimit. "Për sa i përket Shqipërisë dhe Maqedonisë

së Veriut shpresojmë t'i hapim negociatat e anëtarësimit në muajin tetor", deklaroi Rinne. Kryeministri finlandez Antti

Shala: Ekipëve inovative u duhen vegla dhe infrastrukturë për t'i transformuar idetë e tyre



Prishtinë, 19 korrik (ER) - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN), Muzafer Shala, të premten ka vizituar Qendrën e Inovacionit në Fakultetin e Inxhinierisë në Universitetin e Prishtinës, projekt ky i përkrahur nga MIN. "Ekipëve inovative u duhen vegla dhe infrastrukturë për t'i transformuar idetë e tyre, prandaj kam zgjedhur që vizitën e parë ta bëj pikërisht te Qendra e Inovacionit në Fakultetin e Inxhinierisë në Universitetin e

Prishtinës, projekt investues nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë", ka thënë ai. Ministri Shala ka premtuar përkrahje për inovatorët dhe ekipet inovative, të cilët do t'i zhvillojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. "Natyrisht që ky investim do të jetë i suksesshëm duke marrë parasysh gatishmërinë e stafit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, të cilët tashmë janë në përfundim të planit strategjik për funksionalizimin e kësaj qendre që do të jetë

në shërbim të studentëve të UP-së, ndërmarrjeve inovative në proces të parinkubimit dhe inkubimit dhe për të gjithë të rinjtë e interesuar për përgatitjen profesionale në fushën e inovacionit", ka thënë Shala. Sipas ministrit Muzafer Shala, duhet fuqizim i kërkimeve shkencore si dhe transferim i teknologjisë nga universitetet dhe kolegjet për zhvillimin e ideve dhe bizneseve inovative të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Basha: Rama një hajdut psikik, do t'i hetojmë të gjithë grabitësit e Shqipërisë

Tiranë, 19 korrik - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka dalë në një konferencë të jashtëzakonshme lidhur me miratimin e PS-së të koncesioneve private. Nga selia blu kreu i demokratëve tha se opozita sapo të vijë në qeveri do të

ndërmarrë një operacion të gjerë për hetimin, zbulimin dhe ndëshkimin e vjedhjeve që i janë bërë Shqipërisë. "Siç është bërë publike, qeverisja kriminale e Edi Ramës po vazhdon grabitjen dhe tjetërsimin e ekonomisë dhe

pasurive publike të vendit me anë të koncesioneve kriminale, që kanë për qëllim grabitjen e Shqipërisë për llogari të tij dhe një grushti klientësh. Gjithçka tjetër ka ndaluar. Gjithçka tjetër ka marrë fund në këtë qeverisje. Vetëm një gjë forco-

het dhe mritet përditë - vjedhja dhe grabitja e pasurive dhe parave publike. Edi Rama është hajduti më i madh që ka njohur historia e Shqipërisë, një grabitës psikik, që vjedh çdo gjë që i del përpara", ka thënë Basha.



Analistët komentojnë propozimin e kryediplomatit spanjoll Josep Borrell për postin e përfaqësuesit të Lartë për Punë të Jashtme i BE-së

Pse ka skepticizëm te shqiptarët emërimi i Borrellit për shef të diplomacisë evropiane?

Njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të integritimeve evropiane kanë bërë me dije se nuk duhet ngutur duke dhënë vlerësime ndaj propozimit të kryediplomatit spanjoll Josep Borrell për postin e përfaqësuesit të Lartë për Punë të Jashtme i BE-së. Lisen Bashkurti dhe Taulant Kryeziu kanë thënë se duhet bërë dallime në mes të Borrellit si kryediplomat i Spanjës dhe Borrellit si kryediplomat i BE-së. Sipas tyre, ai mund të ketë ndikim pozitiv në dialogun Kosovë - Serbi



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 19 KORRIK - Njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe integritimeve evropiane nuk besojnë se propozimi i kryediplomatit spanjoll Josep Borrell Fontelles për postin e përfaqësuesit të Lartë për Punë të Jashtme i BE-së se do të ndikojë keq për Kosovën. Ata kanë thënë se nuk duhet paragjykuar rolin e kryediplomatit spanjoll në këtë post.

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, diplomati Lisen Bashkurti, ka thënë se emërimi i diplomatit spanjoll Josep Borrell Fontelles në krye të shërbimit të jashtëm të BE-së ka ngjallur skepticizëm në mjaft qarqe politike dhe diplomatike evropiane. "Te shqiptarët e Kosovës ky skepticizëm duket të jetë më i lartë. Unë i kuptoj arsyet historike, politike, mentale dhe psikologjike të shqiptarëve të Kosovës për këtë skepticizëm. Por, natyrisht, nuk i justifikoj ato", ka thënë Bashkurti për gazetën "Epoka e re".

Ai ka thënë se duhet bërë dallimin në mes të Fontelles si diplomat i Spanjës dhe Fontelles si kryediplomat i BE-së pasi, sipas Bashkurtit, ka një

ndryshim themelor. "I pari përfaqësonte interesat kombëtare të Spanjës, politikën e jashtme dhe diplomacinë e saj, i dyti interesat e Bashkimit Evropian, politikën e jashtme dhe diplomacinë e organizatës. I pari përfaqësonte një shtet, Spanjën, i dyti njëzetetete shtete, pra BE-në. Midis politikës së jashtme dhe diplomacisë së Spanjës dhe politikës së jashtme dhe diplomacisë së BE-së ka dallime dhe ngjashmëri. Dallimet konsistojnë në dimensionin kombëtar spanjoll, ngjashmëritë në linjat e përbashkëta të BE-së. Kalimi nga diplomat nacional në diplomat i BE-së nuk lejon parimisht dhe praktikisht që të barten apo të transferohen politikat e diplomacia nacionale në nivele evropiane të BE-së", ka thënë Bashkurti. Sipas tij, diplomati i BE-së vepron nën flamurin e organizatës dhe në mbrojtje të linjave të politikës së jashtme dhe diplomacisë së saj. "Ky proces është i rregulluar qartësisht në të drejtën ndërkombëtare, diplomatike dhe konsullore të OKB-së, e cila bën dallimin midis diplomatëve të shteteve nacionale dhe atyre të organizatave ndërkombëtare. Gjithashtu, Traktati Lisbonës i

BE-së, në kapitullin e tretë, për politikën e jashtme dhe të sigurisë, në artikujt për Veprimin e Shërbimit të Jashtëm të BE-së (EEAS), përcakton qartë dallimin midis shërbimit të jashtëm të BE-së nga ai i shteteve individuale", është shprehur Bashkurti.

Kurse kryetari i Bordit Ekzekutiv të Institutit EPIK, Taulant Kryeziu, ka deklaruar se sa i përket nominimit të Borrellit për përfaqësues të lartë të BE-së nuk duhet nxituar me gjykime rreth qëndrimeve të tij në kohën sa ka shërbyer ministër i Jashtëm i Spanjës. "Asokohe qëndrimi i lidershipit të Spanjës ndaj

Kosovës ishte i qartë dhe puna e z. Borrell ka qenë që ta zbatojë këtë qëndrim. Në rolin e tij të ri, si përfaqësues i jashtëm i BE-së, z. Borrell nuk do t'i përfaqësojë interesat e Spanjës, por të 28 vendeve anëtare të BE-së. Si i tillë, z. Borrell do t'i zbatojë politikën e përcaktuara nga liderët e 28 vendeve anëtare në mirëbesim. Në këtë drejtim, politikën e BE-së ndaj Kosovës janë të qarta. Kosova ka perspektivë të zgjerimit, në harmoni me vende të tjera të rajonit", ka thënë ai.

Kryeziu ka thënë se fakti që Borrell vjen nga një vend mosnjohës mund të shërbejë edhe si avantazh. "Pasi ai

mund të ushtrojë një ndikim më të theksuar drejt vendeve mosnjohëse të BE-së, duke u konsideruar aktor neutral dhe i besueshëm nga to. Marrë parasysh pozicionin e Spanjës si një vend mosnjohës, do të thotë se z. Borrell do të shihet si një figurë më simpatike në Beograd sesa shumë figura të tjera evropiane. Nëse kjo shfrytëzohet mirë, kjo do t'i japë atij një shkallë të madhe të ndikimit atje. Po ashtu, Borrell ka një mundësi të madhe para vetes, Serbia nuk mund t'i qaset në mënyrë armiqësore atij, duke ditur faktin që ai do të ketë ende ndikim në Madrid", ka thënë Kryeziu.

Ambasadorët Kosnett dhe O'Connell përkrahin vendimin e KShC-së

PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë (ShBA), Philipp Kosnett, dhe ai i Britanisë së Madhe, Ruairi O'Connell, kanë dalë në mbrojtje të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) për mosakordimin e disa universiteteve publike dhe private. Sipas ambasadorit amerikan, vendimi i KShC-së ka qenë i vështirë, por korrekt. "Është roli i saj që të marrë vendime objektive dhe të bazuara në standarde, për t'ua siguruar studentëve të Kosovës arsimin cilësor që e meritojnë", ka shkruar Kosnett në një postim në llogarinë e vet në

"Twitter", duke shtuar se Kosova ka nevojë për një sistem edukimi, të bazuar në merita për të gjithë. "Universitetet ekzistojnë për t'i edukuar studentët për përfitimet e tyre dhe të shoqërisë e jo për t'u siguruar punë individëve të pakualifikuar", ka vlerësuar ai. Ndërsa ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka deklaruar se të rinjtë e Kosovës meritojnë një edukim të mirë që njihet ndërkombëtarisht. "Institucionet e pavarura duhet të lejohen të veprojnë në mënyrë të pavarur pa ndërhyrje politike. Vendimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë për

tërheqjen e akreditimit është një vendim i vështirë, por universitetet duhet të plotësojnë disa kriterë, veçanërisht nëse duan që vendet e tjera evropiane t'i njohin diplomat e tyre. Nëse universitetet kanë dështuar, pavarësisht prej paralajmërimeve, për t'i përmbushur kërkesat minimale të cilësisë, është faji i tyre, jo faji i Këshillit", ka shkruar O'Connell në profilin e vet në "Facebook", duke shtuar se shteti i tij ka ndihmuar shumë Kosovën në këtë drejtim. "Qeveria britanike dhe Këshilli Britanik i Akreditimit janë përpjekur t'i ndihmojnë universitetet publike dhe private për t'i



përmbushur kërkesat e cilësisë. Tani kjo çështje është një provë e vërtetë për Kosovën. Rezultati do të tregojë nëse sistemi arsimor i Kosovës është ndërtuar për t'u

shërbyer qytetarëve të saj dhe interesit kombëtar, ose për t'i shërbyer një grupi të ngushtë njerëzish dhe interesash private", është shprehur O'Connell.

Gjykata Speciale ka ftuar për intervistim kryeministrin Ramush Haradinaj në cilësinë e të dyshuarit

Gjenerali i përgjigjet S

Ramush Haradinaj ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga posti i kryeministrit të Republikës së Kosovës. Ai ka bërë me dije se arsyeja e kësaj dorëheqje është ftesa nga Gjykata Speciale në cilësinë e të dyshuarit. Lajmin e dorëheqjes Haradinaj e ka konfirmuar të premtën në mbledhjen e kabinetit qeveritar dhe në një konferencë për medie. Ai ka treguar se qeveria e dorëhequr do ta vazhdojë punën deri në formimin e qeverisë së re. Haradinaj i ka bërë thirrje presidentit Thaçi që në afatin kushtetues t'i kryejë konsultimet me partitë politike dhe t'i shpallë zgjedhjet e parakohshme. Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se në Hagë do të dalë përballë shpifësve ashtu si e kërkon nderi i luftëtarit shqiptar. Ai ka thënë se pastërtia e tij dhe e luftës së UÇK-së nuk mund të njolloset nga askush dhe asnjëherë



EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 19 KORRIK - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, të premtën ka dhënë dorëheqje nga ky post. Dorëheqja e tij ka ardhur pas ftesës nga Gjykata Speciale për t'u intervistuar në cilësinë e të dyshuarit. Lajmin e dorëheqjes Haradinaj e ka bërë mes lotësh në mbledhjen e rregullt të kabinetit qeveritar dhe në një konferencë për medie. "Të nderuar qytetarë, dua t'ju informoj se sot kam marrë këtë vendim: Jap dorëheqje të parevokueshme nga detyra e kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe dua t'ju falënderoj për besimin dhe përkrahjen. Arsyeja e këtij vendimi është se kam marrë thirrje të paraqitem për t'u marrë në pyetje nga Dhomat e Specializuara në Hagë si i dyshuar", ka deklaruar ai. Kryeministri në largim ka thënë se në Hagë do të dalë përballë shpifësve ashtu si e kërkon nderi i luftëtarit shqiptar. Në këtë kontekst, ai ka theksuar se pastërtia e tij dhe e luftës së UÇK-së nuk do të mund të njolloset asnjëherë. "Qeveritë dhe pushtetet janë të ndërrueshme, jetojmë në demokraci. Nderi i kryeministrit dhe shtetit duhet të ruhet dhe unë nuk e poshtëroj asnjëherë. Në Hagë si Ramush Haradinaj do t'u dalë përballë shpifësve ashtu si e kërkon nderi i luftëtarit shqiptar. Pastërtia ime dhe e luftës së UÇK-së, e konfirmuar nga dy aktgjykime, nuk mund të njolloset nga askush dhe asnjëherë", ka theksuar Haradinaj. Ai ka thënë se Kosova do të mbetet e paprek-

shme në territor dhe në kufij. Sipas Haradinajt, ndarja apo 'Dodik Republika' janë të papërbalueshme për Kosovën dhe stabilitetin e rajonit. "Shteti im është Kosova, e paprekshme në multietnicitet, shumëgjuhësi, në territor dhe kufij. Kosovës i bëhet presion i padrejtë për çmimin e njohjes nga Serbia. Ndarja apo Dodik Republika janë të papërbalueshme për Kosovën dhe stabilitetin e rajonit", është shprehur ai, duke shtuar se bashkësia ndërkombëtare po bën gabim që po insiston në çmim të papërbalueshëm për Kosovën për njohje. Po ashtu, sipas Haradinajt, lidhshipi kosovar po bën gabim se nuk po e fuqizon legjitimitetin e vendimit për taksën ndaj Serbisë. "Si kryeministër i Qeverisë së Kosovës besoj fuqishëm se çmimi për njohje është tregu dhe për këtë taksë duhet të jetë çmimi i njohjes. Bashkësia ndërkombëtare po bën gabim që po insiston në çmim të papërbalueshëm për Kosovën për njohje. Lidhshipi kosovar po bën gabim se nuk po e fuqizon legjitimitetin e vendimit për taksën ndaj Serbisë. Herët a vonë do ta kuptojmë se sa dëm i madh po i bëhet vendit me këtë mosunitet. Kosova euroatlantike është e interesuar për njohje reciproke në kufijtë ekzistues. Dialogu për njohje është edhe rruga për tregti të lirë me Serbinë. Kurrë nuk është vonë të jemi bashkë - tregu për njohje, e jo ndarja apo Republika e Dodikut. Më lejoni t'ju siguroj se: Taksë mbetet, Ushtria e Kosovës shkon para, 'Trepça' është e gatshme për investime", ka deklaruar ai.

Kryeministri në largim e ka ftuar presidentin e vendit, Hashim Thaçi, që në afatin kushtetues t'i kryejë konsultimet me partitë politike dhe t'i shpallë zgjedhjet e parakohshme. Sipas tij, qeveria e dorëhequr vazhdon t'i kryejë funksionet e veta deri në formimin e qeverisë së re e cila do të jetë rezultat i zgjedhjeve të lira dhe demokratike. "Pas kësaj dorëheqjeje mandatin ia kthej popullit. Sovrani të vendosë për udhëheqjen e ardhshme me zgjedhje të lira dhe demokratike. I drejtohem presidentit që në afatin kushtetues t'i kryejë konsultimet me partitë politike dhe t'i shpallë zgjedhjet e parakohshme. Qeveria e vendit

vazhdon t'i kryejë funksionet e veta pa lejuar vakuum qeveritar deri në qeverinë e re që do të dalë nga zgjedhjet e lira dhe demokratike. Menjëherë do t'u drejtohem me shkresa zyrtare për dorëheqjen e parevokueshme institucioneve të vendit dhe udhëheqësve të koalicionit qeverisës. Do t'i shërbej me besnikëri, gjithë jetën, popullit, atdheut dhe shtetit tim, Kosovës. Faleminderit!", ka thënë kryeministri në largim Ramush Haradinaj. Kjo nuk është hera e parë që Haradinaj jep dorëheqje. Ai pati dhënë dorëheqje nga posti i kryeministrit edhe më 8 mars të vitit 2005, vetëm 100 ditë pasi kishte marrë detyrën, pas

aktakuzës së parë të ngritur nga Tribunali i Hagës për krime lufte. Haradinaj ishte dorëzuar vullnetarisht në Gjykatën e Hagës. Në vitin 2008 Gjykata e Hagës e shpalli atë të pafajshëm. Por katër vjet pas u bë rigjykimi i tij, po në Tribunalin e Hagës, me ç'rast në vitin 2012 Ramush Haradinaj sërish u shpall i pafajshëm për të gjitha akuzat që e ngarkonin atë për krime lufte. Një proces tjetër ndaj tij u ndoq edhe në vitin 2017, por kësaj radhe në Colmar të Francës, ku autoritetet franceze, më 4 janar, e ndaluan mbi bazën e një fletarrestimi të lëshuar nga Serbia për krime lufte. Por, pas një procesi gjyqësor ndaj tij, drejtësia franceze e kishte liru-

Speciales për UÇK-në



ar atë më 27 prill. Ramush Haradinaj u zgjodh për herë të dytë në postin e kryeministrit të Kosovës më 9 shtator të vitit 2017.

Reagimet pas dorëheqjes së kryeministrit Haradinaj

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka reaguar pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se e respekton këtë vendim të Haradinajt dhe, sipas tij, askush nuk mund ta cenojë luftën e UÇK-së. Thaçi ka bërë me dije se do të veprojë bazuar në kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, për të cilat qytetarët e Kosovës do të njoftohen me

kohë. "Me keqardhje mësova që Gjykata Speciale ka ftuar për intervistim ish-shefin e Shtabit të UÇK-së, Bislim Zyrap, njëherësh këshilltar imi, ish-komandantin e Zonës Operative të Dukagjinit, kryeministrin Ramush Haradinaj, si dhe disa ish-eporë të tjerë të UÇK-së. Nga mediet tani u informova edhe për vendimin e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, për dorëheqjen e parevokueshme nga pozita e tij. Unë e respektoj vendimin e tij dhe si president i Republikës së Kosovës ju siguroj se do të veprojmë bazuar në kompetencat e mia kushtetuese dhe ligjore, për të cilat qytetarët e Kosovës do të njoftohen me

besoj në pastërtinë e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe besoj në vlerat e larta morale të ushtarëve të lirisë. As vlerat e lirisë sonë dhe as luftën e UÇK-së nuk mund ta cenojë askush", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Ndërsa kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se me keqardhje ka mësuar lajmin për dorëheqjen e Ramush Haradinajt nga posti i kryeministrit pas ftesës nga Gjykata Speciale për intervistim. Veseli në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se koalicioni qeveritar me Haradinajn kryeministër ishte ndërtuar për të marrë vendime të mëdha dhe për ta mbrojtur UÇK-në.

"Me keqardhje mësova nga mediet për thirrjen që u është bërë nga Gjykata Speciale bashkëluftëtarëve të mi si dhe për dorëheqjen e kryeministrit Ramush Haradinaj. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë e pastër dhe e drejtë dhe jam i sigurt se ndershmëria e luftës së popullit tonë për liri dhe pavarësi ka për t'u vërtetuar sërish. Koalicioni qeveritar u ndërtua për të marrë vendime të mëdha për Kosovën dhe për t'i mbrojtur vlerat e UÇK-së. Të gjitha veprimet dhe vendimet tona do të jenë vetëm në shërbim të interesave më të mira të Kosovës dhe qytetarëve tanë, si dhe në përputhje të plotë me ligjet tona", ka shkruar Veseli. Ndërsa kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë se ndien keqardhje për dorëheqjen e Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit për shkak të ftesës së Gjykatës Speciale. Mustafa ka thënë se lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe e pastër prandaj, sipas tij, pafajësia e Haradinajt do të konfirmohet edhe kësaj radhe. "Qytetarë të nderuar, LDK-ja në vazhdimësi ka kërkuar që kjo qeveri të japë dorëheqje, por ndiejmë keqardhje që kjo ndodhi për shkak të ftesës për kryeministrin e Kosovës nga Dhomat e Specializuara. Besoj fuqishëm se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë e drejtë dhe e pastër dhe, po ashtu, besoj se pafajësia e z. Haradinaj do të provohet edhe kësaj radhe", ka shkruar Isa Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka reaguar pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit të Kosovës. Kurti në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se

dorëheqja e Haradinajt është e vonuar me arsye të gabuar. Sipas tij, Lëvizja Vetëvendosje ka qenë dhe është kundër Gjykatës Speciale. "Kemi nevojë për gjykata normale kundër kriminit dhe korrupsionit në paqe dhe jo edhe për një gjykatë speciale kinse kundër krimeve të luftës së UÇK-së. Ata që e votuan e vunë veten e tyre dhe gjithë Kosovën nën shantazhin e interesave gjeopolitike jashtë kontrollit tonë. Për drejtësi të vërtetë, zhvillim të qëndrueshëm, përparim shoqëror, demokraci institucionale, menjëherë nevojiten zgjedhje të reja parlamentare. Duhet të flasë populli të cilin aq shumë e shtypën dhe e zhvatën", ka thënë Kurti. Edhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka reaguar për dorëheqjen e kryeministrit Ramush Haradinaj pas ftesës për intervistim nga Gjykata Speciale. Limaj, i cili mban postin e zëvendëskryeministrit, ka thënë se kjo ftesë është e padrejtë por, sipas Limajt, Kosova do ta kalojë me sukses edhe këtë sfidë dhe drejtësia do të ngadhënjejë edhe në këtë rast. "Ftesa për intervistë nga Gjykata Speciale në cilësinë e të dyshuarit për kryeministrin e Qeverisë së Kosovës, Ramush Haradinaj, është një ftesë e padrejtë nga një gjykatë e padrejtë, ashtu sikur që janë të padrejta ftesat për drejtues dhe luftëtarë të tjerë të UÇK-së. Fatkeqësisht, kjo gjykatë është themeluar nga Kuvendi i Kosovës, prandaj alternativa e vetme është përballja me fakte kundër shpifjeve të armiqve të Kosovës. Kosova do ta kalojë me sukses edhe këtë sfidë dhe drejtësia do të ngadhënjejë edhe në këtë rast", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Çfarë pritet të ndodhë tash me qeverinë?

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht në Nenin 95, Pika 5, thuhet se: "Nëse kryeministri jep dorëheqje ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, qeveria bie dhe presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri për ta formuar qeverinë".

Lidhur me këtë çështje ka folur profesori universitar i së Drejtës Kushtetuese, Flamur Hyseni. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka shkruar se në aspekt juridik, nëse ka shumicë parlamentare aktive nga koalicioni qeverisës, mund të mandatohet kandidati i ri për kryeministër për ta formuar qeverinë. "Që do të thotë, nuk është e domosdoshme të shpallen zgjedhjet e parakohshme. Në aspekt politik, gjithçka është e mundur", ka shkruar Hyseni.

Bytyqi nënshkruan udhëzimin administrativ për zgjedhjen e drejtorit në institucionet publike edukativo-arsimore

PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka nënshkruar Udhëzimin Administrativ të hartuar nga MASHT-i dhe që ka për qëllim t'i përcaktojë detyrat, përgjegjësitë,

kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës-drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës. "Për të mirën e fëmijëve më shumë se

prindërit nuk përkushtohet askush dhe për këtë, bazuar edhe në udhëzim, do të jenë prindërit dhe kolektivi i shkollës ata të cilët do të kenë rol kyç dhe vendimtar në këtë proces kaq të rëndësishëm. Përmes këtij

Udhëzimi Administrativ, që është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore, synohet të jetësohet zotimi ynë që prej kur jemi në krye të këtij dikasteri, depolitizimi i sistemit arsimor", ka thënë ministri Bytyqi.



Haradinaj: Bota duhet ta njohë realitetin e Kosovës dhe atë se kush jemi ne

EPOKA E

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të premten në takim një grup prej 55 studentëve të programit Akademia Verore, nga 28 shtete të ndryshme të botës. Kryeministri Haradinaj u uroi mirëseardhje studentëve dhe i përgëzoi organizatorët për këtë vizitë, duke thënë se sjellja e studentëve dhe të rinjve nga kombe të ndryshme në Kosovë është një gjë e mirë sepse, siç theksoi kryeministri Haradinaj, është shumë e rëndësishme që shumë njerëz të botës të na njohin se kush jemi ne. "Kosova është një komb i ri dhe jemi shtet i pavarur që 11 vjet. Jemi shtet shumetnik. Ky është shteti

ynë dhe ne ndajmë besimin në vlerat e përbashkëta evropiane. Kemi shumë sfida si komb i ri dhe shoqëri. Sfida kryesore për ne ishte ekonomia e shkatërruar gjatë luftës 20 vjet më parë dhe për shkak të saj ka ende mungesë të vendeve të punës për rininë tonë", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke thënë se sundimi i ligjit ka përmirësuar dhe është duke e përmirësuar luftimin e korrupsionit.

Në fjalën e tij para studentëve, kryeministri Haradinaj ka deklaruar se është sfidë për Kosovën themelimi i besimit brenda komuniteteve, por theksoi se është bërë përparim në këtë drejtim, por ende duhet punë për t'u bërë. "Po ashtu, presim edhe një marrëveshje me Serbinë për njohjen reci-



proke në kufijtë ekzistues dhe shpresojmë se dialogu do ta sjellë këtë dhe se përmes kësaj do të mund të bashkoheshim me BE-në, NATO-n, në një botë ku rreshtohemi me parimet që

drejtohen nga ShBA-ja dhe të gjithë aleatët tanë që na kanë ndihmuar", ka thënë kryeministri Haradinaj. Pas fjalës së tij kryeministri Haradinaj zhvilloi një

bashkëbisedim me studentët dhe u përgjigj në shumë pyetje rreth punës së tij si kryeministër, për sfidat e qeverisjes dhe drejtimin që ka marrë Kosova.

UBT-ja po ndërton objektin më të madh universitar në Kosovë



PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Rreth 28 mijë metra katrorë do të jetë objekti më i ri universitar i UBT-së që do të jetë unik dhe i pari i këtij lloji në Kosovë. Brenda këtij objekti do të krijohen salla ligjërimit dhe praktike, konvikte, laboratorë, biblioteka, kuzhina dhe të gjitha elementet e tjera për të cilat kanë nevojë studentët.

Ky objekt do ta kompletojë edhe më shumë kompleksin universitar të UBT-së i cili ua ofron studentëve frymën e veçantë dhe të re të të studiuarit në një institucion ndërkombëtar. "Ky objekt do të jetë i katërti brenda Kompleksit

Inovativ të UBT-së në Lipjan, kurse kjo e bën UBT-në institucionin e vetëm në Kosovë dhe rajon me Park Shkencor, në të cilin zhvillohet shkencë, kryhen eksperimente, formohen produkte dhe marrin jetë projektet më të reja në vend", është thënë në njoftimin e UBT-së.

Më tutje është theksuar se me rritjen e numrit të studentëve UBT-ja ka shumëfishuar hapësirën në kompleksin inovativ, ku gjenden objekte të mëdha e me shumë hapësira rekreative, laboratorë të sofistikuar, biblioteka me më shumë se 200 mijë tituj

shkencorë, hapësira punuese dhe mësimi për studentët.

Të gjitha këto tash e shumë vite janë në shërbim të studentëve të UBT-së të cilët natyrshëm shndërrohen në ekspertë të të gjitha fushave të studimit, pasi kanë mundësi dhe forma të panumërta për aftësim profesional dhe akademik përbrenda UBT-së. "I tërë ky investim është bërë dhe po bëhet me qëllim të përgatitjes së studentëve për tregun vendor dhe ndërkombëtar të punës, ku studentët e UBT-së gjithmonë janë më të dalluarit dhe më të përgatiturit", është thënë në njoftimin e UBT-së.

Policia i shpreh ngushëllime familjes së nëntëvjeçarit që u vra në Fushë-Kosovë

PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - "Më 17 korrik një djalosh nëntëvjeçar u vra në Fushë-Kosovë. Vendi ynë, institucionet e drejtësisë dhe qytetarët janë të tronditur nga humbja tragjike e djaloshit të ri. Me zemër dhe shpirt ndajmë dhembjen me familjen dhe miqtë", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Policia ka njoftuar se vrasësi i dyshuar është arrestuar dhe po mbahet në paraburgim. "Policia e Kosovës dhe kryeprokurori i shtetit i Republikës së Kosovës po punojnë së bashku për rishikimin e plotë të procedurave, veprimeve dhe rrethanave të kësaj tragjedie të hatashme. Do të punojmë me zell për t'i

trajtuar mangësitë e identifikuar dhe për të zhvilluar protokolle më të mira të cilat do t'i mbrojnë më mirë qytetarët, veçanërisht ata që janë më të cenueshëm në shoqërinë tonë. I shprehim ngushëllimet tona më të thella familjes në këto çaste të rënda", është theksuar në njoftimin e Policisë së Kosovës.



Gjenerali i NATO-s informohet me planin e tranzicionit të FSK-së

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 19 KORRIK - Ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rahman Rama, janë takuar në takime të ndara me gjeneralin Tod Wolters, komandant Suprem i Forcave Aleate për Evropë, në takime të ndara. Ministri Berisha e ka informuar gjeneralin Wolters për planin gjithëpërfshirës të tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe implementimin e tij në bashkëpunim të ngushtë me aleatët.

Gjithashtu, ministri Berisha e ka njoftuar gjeneralin Wolters, me theks të veçantë rreth përparimit të arritur gjatë 120 ditëve të para të tranzicionit. "Forca e Sigurisë së Kosovës edhe me mandatin e ri do të vazhdojë të ndërtohet si forcë profesionale, shumetnike dhe e besueshme", është shprehur ministri Berisha.

Ndërsa komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rahman Rama, gjatë takimit me komandantin suprem të NATO-s, gjeneralin Tod Wolters, e ka njoftuar atë me zhvillimet e FSK-së, të arriturat e përgjithshme si dhe sfidat.

Gjenerali Rahman Rama me gjeneralin Tod Wolters biseduan edhe për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në mes të NATO-s dhe FSK-së, për zhvillimin e një force profesionale me standarde të NATO-s. Komandanti Suprem i NATO-s për Evropë, gjenerali Wolters, e ka falënderuar ministrin Berisha dhe komandantin Rama për takimin, për përkrahjen e vazhdueshme për KFOR-in për zbatimin e misionit të tij në Kosovë dhe, ndër të tjera, përsëriti zotimin e NATO-s dhe të KFOR-it për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë dhe rajon.



Kosova dhe Maqedonia nënshkruajnë memorandum në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

SHKUP, 19 KORRIK - Përfaqësuesit e Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) morën pjesë në takimin zyrtar me përfaqësuesit e zyrës homologe të Maqedonisë së Veriut. Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli, së bashku me një delegacion nga Agjencia Kundër Korrupsionit, u takuan me përfaqësuesit e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në Maqedoni Veriore.

Drejtori Havolli u prit në takim nga Biljana Ivanoska, kryetare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në Maqedoni, të shoqëruar me përfaqësuesit e tjerë, anëtarët dhe nëpunësit e këtij komisioni.



Në këtë takim të dyja palët diskutuan për punët dhe sfidat e institucioneve në fushën e ndryshimeve legislative, pro-

cesin e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë, konfliktit të interesit si dhe për forcimin e mekanizmave aktualë në paran-

dalimin dhe luftimin sa më efikas të korrupsionit. Në këtë takim palët nënshkruan memorandum për

bashkëpunim mes të dyja institucioneve për bashkëpunim në bazë të kompetencave të tyre sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi në vendet respektive.

Ky memorandum ka për qëllim ta zyrtarizojë bashkëpunimin me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave në mes palëve në fushat që lidhen me parandalimin e korrupsionit, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, parandalimin e konfliktit të interesit ushtrimin e funksionit publik dhe parandalimin e korrupsionit në aktivitetet e prokurimit publik.

Ky bashkëpunim do të fokusohet në shkëmbimin e njohurive dhe përvojave në fushat e lartpërmendura me qëllim të zbatimit të praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare.

Juniku proteston për mbrojtje të lumit Erenik

JUNIK, 19 KORRIK (ER) - Të premten në Junik është mbajtur protestë në lokacionin ku po zhvillohen punimet jashtëligjshëm dhe në devijim të rrjedhës natyrore të lumit Erenik.

Protesta përcolli mesazhin e qytetarëve dhe Komunës së Junikut që në asnjë rast nuk kanë qenë, nuk janë dhe nuk do të jenë që shtëpitë e qytetarëve të Rekës e Lugut të mos kenë ujë të pijes, që është një e

drejtë njerëzore, natyrore e garantuar me çdo normë kushtetuese dhe ligjore të cilën qytetarët e Junikut e kanë dëshmuar me shekuj e dekada në robëri e varfëri.

Edhe një herë kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, nga vendi ku KRU-Gjakova jashtëligjshëm është duke vazhduar punimet, i ka bërë thirrje kryeministrit të Kosovës, njëherësh edhe kryetar i Këshillit

Ndërmintor të Ujërave, Ramush Haradinajt, që sa më parë t'i shfuqizojë vendimet e paligjshme të MMPH-së, t'i ndalojë të gjitha veprimet e paligjshme të Komunës së Gjakovës dhe që KRU Gjakova të veprojë ligjshëm me drejtësi dhe në interesin e përgjithshëm.

Kryetari Kuçi ka bërë me dije se Komuna e Junikut do t'i shfrytëzojë të gjitha mjetet ligjore dhe demokratike në mbrojtje



të pasurive kombëtare, në këtë rast si për lumin Erenik,

natyrën, mjedisin ekologjik dhe biodiversitetin.

Të hyrat e ATK-së shënuan

Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka thënë se institucioni që drejton ka arritur të inkasojë 19.5 milionë euro më shumë se në periudhën paraprake apo, shprehur në përqindje, 8.9 për qind më shumë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 KORRIK - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka mbajtur të premtën konferencë për medie në të cilën ka paraqitur të arriturat dhe aktivitetet e këtij institucioni për periudhën janar - qershor për këtë vit. Në këtë konferencë i pranishëm ishte dhe ministri i Financave, Bedri Hamza.

Drejtori ATK-së, Ilir Murtezaj, ka thënë se institucioni që drejton ka arritur t'i inkasojë 19.5 milionë euro më shumë se periudha paraprake apo, shprehur në përqindje, 8.9 për qind më shumë. "Në periudhën janar - qershor të vitit 2019 janë grumbulluar 239.5 milionë euro nga të hyrat nga tatimet, kurse nga kontributet pensionale 85.5 milionë euro. Në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishin 219.9 milionë euro nga të hyrat nga tatimet, kurse nga kontributet pensionale 83.9 milionë euro", ka deklaruar Murtezaj, duke shtuar se kjo rritje ka ardhur në sajë të masave të mbledhjes së borxheve dhe rritjes së aktiviteteve ndaj evazionit fiskal. "Një ndër elementet kyçe që ka ndikuar në rritjen e të hyrave është pjesa e mbledhjes së borxheve që kemi një performancë të rritur rreth 27 për qind më tepër sesa periudha e njëjtë e vitit të kaluar, pastaj janë edhe

aktivitetet e tjera shtesë në drejtim të identifikimit të evazionit fiskal", ka Murtezaj.

Ai ka theksuar se janë 44.9 milionë euro borxhe të mbledhura. "Nga mbledhja e ndëshkimeve janë 4 985 raste të trajtuara. Borxhi i trajtuar është 3.8 milionë euro, nga të cilat janë inkasuar 1.5 milionë euro. Gjatë këtij gjashtëmujori janë identifikuar 81 aktivitete për shmangie nga tatimi, ndërkaq 23 raste janë të hapura nën dyshim të shmangies tatimore. Janë realizuar 51 intervista me të dyshuar dhe dëshmitarë. Kanë qenë 92 informata për institucionet e zbatimit të ligjit, pra janë 4.58 milionë euro nga vlera e shmangies tatimore pa ndëshkime dhe interesa", u është shprehur Murtezaj.

Ai ka kërkuar nga ministri i Financave, Bedri Hamza, që stafi i ATK-së të largohet nga shërbimi civil pasi, sipas tij, ligji aktual po krijon vështirësi dhe që të trajtohen njëloj sikur Dogana dhe Policia. Kurse ministri i Financave, Bedri Hamza, ka inkurajuar ATK-në që të jetë në kuadër të linjave dhe ta vazhdojë luftimin e informalitetit. Ai ka vlerësuar punën e stafit të ATK-së, duke thënë se rritja e të hyrave për këtë periudhë gjashtëmujore është falë angazhimit maksimal të ATK-së. "Është për t'u vlerësuar rritja e të hyrave. Duhet theksuar se rritja ka ardhur jo për shkak të ndonjë norme të re tatimore,



por si rezultat i rritjes së performancës së ATK-së dhe disiplinimit të bizneseve për të paguar. Si Ministri e Financave do të jemi gjithmonë në përkrahje të ATK-së. Fokusi ynë do të jetë luftimi i informalitetit. Dhe në këtë drejtim ka inkurajim sepse kemi zvogëlim të stokut të borxhit dhe fillim të procesit të konfiskimit. Të vazhdojmë kështu, sepse nuk ka mundësi një tatimpagues të mbledhë tatim nga konsumatori dhe të mos i paguajë shtetit. Duhet të ketë trajtim të barabartë të tatimpaguesve, sepse nuk mund dikush të paguajë taksë e

dikush jo. Pra, ju inkurajoj ta zbatoni ligjin drejt dhe të trajtohen gjithë të tatimpaguesit drejt", ka thënë Hamza.

Ai ka pohuar se ruajtja e stabilitetit makrofiskal është detyrim dhe prioritet i prioritetëve dhe se borxhi publik është vetëm 18 për qind e GDP-së. "Detyrimisht jemi të detyruar të qëndrojmë në kuadër të stabilitetit makrofiskal. Nëse shteti humb stabilitetin makrofiskal atëherë s'ka prioritete të tjera. Prandaj, stabiliteti makrofiskal është prioritet i prioritetëve. Kosova ka pozitë të mirë makrofiskale, kurse trendi i të

hyrave është në përputhje me planifikimet që do të na mundësojë që deficit të jetë më i vogël se ai i planifikuar. Ne nuk kemi vonesa në asnjë pagesë, pra as për pensione, as për projekte kapitale dhe as për çështje sociale. I inkurajoj të gjitha organizatat buxhetore t'i kryesojnë obligimet e tyre me kohë. Organizatat buxhetore duhet ta dinamizojnë ekzekutimin te projektet kapitale. Borxhi publik vazhdon të jetë në nivel të moderuar, që është 18 për qind dhe nuk kemi pasur ngritje të shpejtë të borxhit publik", ka thënë Hamza.

AKP-ja shpalli shitjen e re të aseteve përmes likuidimit nr. 49, thjeshtëson procedurat e ofertimit

PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) zyrtarisht ka shpallur shitjen e aseteve përmes likuidimit nr. 49. Lista e tenderëve për privatizim me shitje të aseteve nr. 49 përmban 137 asete/njësi atraktive të ndërmarrjeve shoqërore në Republikën e Kosovës, të cilat paraqesin një mundësi të shkëlqyer për zgjerim të biznesit apo iniciativa të reja biznesore në vendin tonë. "Agjencia ka thjeshtësuar akoma më shumë procedurat e ofertimit me ndryshimet që u janë bërë Rregullave të Tenderit, duke mundësuar lehtësime për pro-

cesin e ofertimit. Rregullat e reja të tenderit aplikohen nga kjo valë e shitjeve të aseteve dhe ofertuesit duhet të aplikojnë me procedurat e reja, ndërsa janë të publikuara edhe në uebfaqen e agjencisë. Ofertuesit mund t'i vizitojnë edhe zyrat e AKP-së dhe të njoftohen drejtpërdrejt nga zyrtarët përgjegjës me procedurat e reja të ofertimit", është thënë në njoftimin e AKP-së. Sipas AKP-së, kjo valë e shitjeve me të gjitha asetet e tenderuara është aprovuar në Bordin e Drejtorëve, kurse AKP-ja i ka njoftuar paraprakisht të gjitha komunat përkatëse se këto asete të ndërmarrjeve

shoqërore do të privatizohen dhe ka shpallur njoftimin për tender në faqen e saj të internetit www.pak-ks.org dhe në mediat e shkruara dhe ato elektronike.

Ofertat e mbyllura për njësitë/asetet në vijim duhet të dorëzohen në "Sallën e konferencave - 'Hoteli Grand'", në Prishtinë, më 21 gusht 2019, nga ora 10:00 deri në orën 12:00, të shoqëruara edhe nga depozita e ofertës dhe tarifa për paraqitjen e ofertës, ashtu siç është parashikuar për secilin artikull. Kurse hapja e ofertave do të bëhet po të njëjtën ditë, duke filluar nga ora 12:30.



rritje për 19.5 milionë euro

tronike dhe sistemeve fiskale. Kështu u tha në një njoftimin e AAK-së.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka njoftuar se ka nisur hetimet pas ankesës nga një ndërmarrje e cila pretendon se ATK-ja qëllimisht nuk e ka zbatuar këtë udhëzim administrativ për t'ua pamundësuar të instalojë pajisje të reja fiskale në tregun përkatës. "Dyshimet fillestare janë se me kufizimin e ofrimit të shërbimeve të kompanive të licencuara në tregun përkatës, të pajisjeve elektronike dhe sistemeve fiskale, biznesit i privohet e drejta e zgjedhjes për marrjen e shërbimeve tek operatorët ekonomikë të licencuar. ATK me këto veprime mund të shpie te format e keqpërdorimit të pozitës dominuese, marrëveshjeve të ndaluara apo praktikave të bashkërenduara", është theksuar në njoftimin e AAK-së.

Lidhur me këtë çështje, drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka thënë se është e drejtë e secilit institucion gjegjëses që t'i fillojë hetimet, por ka mohuar që të ketë monopol në shfrytëzimin e pajisjeve elektronike dhe sistemeve fiskale. Ai u është përgjigjur edhe një herë pretendimeve të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës lidhur me hetimet për "keqpërdorim të pozitës dominuese", respektivisht moszbatim të Udhëzimit Administrativ 02/2018 për shfrytëzimin e pajisjeve elektronike dhe sistemeve fiskale. "Ministria e Financave në vitin 2018 ka miratuar një Udhëzim Administrativ përmes të cilit lejohet që të gjitha bizneset, qoftë ato që prodhojnë, importojnë apo pretendojnë për të shitur, ta kenë mundësinë për t'u licencuar si operatorë

ekonomikë. Andaj, nuk ka asnjë kufizim dhe nuk ka asnjë monopol, por është një treg i hapur për të gjithë ata që shprehin interes. Aktualisht kemi gjashtë operatorë që janë të licencuar, nga ta katër kanë të drejtë të shitjes dhe të gjithë kanë mundësi për të shitur, pra

është e drejtë e secilit organ që të hetojë cilindo proces. Ne jemi të hapur për çfarëdo hetimi që mund të jetë. Monopol nuk ka pasi janë katër kompani duke shitur. Deri më tani nuk ka ndonjë kërkesë në pritje për licencim. Inkurajojmë që kushdo që e sheh si potencial për të

zhvilluar aktivitetet të aplikojë dhe nëse i plotësojnë kriteret, atëherë mund të operojnë", ka deklaruar Murtezaj në konferencën e organizuar të premtën me rastin e prezantimit të të arriturave dhe aktiviteteve të ATK-së për periudhën gjashtë-mujore të këtij viti.

Të konsiderohet ndikimi i dispozitave të ligjit të punës në sektorin privat

PRISHTINË, 19 KORRIK (ER) - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar tryezë rreth projektligjit të punës ku është diskutuar për çështje të ndryshme brenda projektligjit të cilat ndikojnë në tregun e punës dhe operimet e bizneseve.

Kryesuesja e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Besa Baftiu, ka thënë se në mënyrë që të adresohen çështjet të cilat ndikojnë në tregun e punës që dalin nga Projektligji i Punës duhet të shqyrtohen edhe komentet e sektorit privat i cili ndikon në operimet e tyre. Në krahasim me projektligjin paraprak, ajo ka thënë se ky ligj është më i avancuar për rregullimin e tregut të punës, duke përfshirë edhe fusha të tjera si pushimi i lehonisë, në bazë të legjislacionit të Bashkimit Evropian, duke shtuar se në këtë projektligj janë përfshirë 70 direktiva të BE-së. Ajo ka shtuar se mirëpresin komentet nga Oda



Amerikane dhe bizneset anëtare të saj të cilat do të ndihmojnë në rishikimin dhe plotësimin e ligjit në mënyrë të duhur.

Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Administratës në Meridian Corporation, Abdylkerim Ratkoceri, ka thënë se, krahasuar me projektligjin paraprak, nuk vërejnë ndryshime të mëdha, duke përmendur disa aspekte të projektligjit si shkëputja e kontratës, pushimi mjekësor dhe pushimi i lehonisë.

Ratkoceri ka thënë se nevojitet

rishikimi i pushimit të lehonisë në ligj pasi që aktualisht përbën barrë ndaj bizneseve dhe ndikon në punësim më të ulët të grave në këtë sektor, duke shtuar se konsiderimi i komenteve të sektorit privat rezulton në qëndrueshmëri dhe barazi në tregun e punës. Më tutje, bizneset adresuan aspekte të caktuara nga projektligji i punës me ndikim në operimet e tyre, duke kërkuar që ligji t'i trajtojë barabartë punëmarrësit dhe punëdhënësit.

MURTEZAJ MOHON TË KETË MONOPOL PËR SHFRYTËZIMIN E PAJISJEVE ELEKTRONIKE DHE SISTEMEVE FISKALE

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) ka nisur hetimet ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për moszbatimin e Udhëzimit Administrativ 02/2018 për shfrytëzimin e pajisjeve elek-

Studentët e Universitetit Veror Ndërkombëtar të Prishtinës mësojnë për rolin e BQK-së

PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka bashkëbiseduar me studentët të edicionit të 19-të të Universitetit Veror Ndërkombëtar të Prishtinës rreth rolit të BQK-së në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit dhe funksionimit të sektorit financiar.

Guvernatori Mehmeti me këtë rast ka theksuar se Kosova ka një sistem financiar stabil, i cili çdo ditë e më tepër po luan rolin e tij të rëndësishëm në përkrahjen e zhvillimit ekonomik të vendit dhe se sektori bankar si komponentë

kryesore e sistemit financiar në vend karakterizohet me rritje të vazhdueshme të zhvillimit në të gjithë indikatorët e saj. "Falë stabilitetit ky sektor është çdo ditë e më tërheqës për investitorët e jashtëm. Stabiliteti financiar të cilin e gëzojmë sot është rezultat i politikave rigorozë fillimisht të licencimit, më pas edhe të mbikëqyrjes dhe rregullimit të institucioneve financiare që operojnë në tregun tonë. I gjithë angazhimi i BQK-së në këtë drejtim është i udhëzuar me direktiva të Bashkimit Evropian dhe bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që kemi me

Bankën Qendrore Evropiane. Si rezultat, BQK-ja ka nisur me zbatimin e kërkesave të Bazel 3 që aktualisht po aplikohet në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, kemi zhvillime pozitive edhe në sektorin e sigurimeve dhe në atë të institucioneve mikrofinanciare dhe atyre financiare jobankare", ka deklaruar Mehmeti.

Nga ana tjetër, drejtuesit dhe studentët e Universitetit Veror Ndërkombëtar të Prishtinës parashtruan pyetje të ndryshme për funksionimin e sektorit financiar në Kosovë dhe falënderuan Guvernatorin Mehmeti për bashkëbisedimin.



Vihet gurthemeli për ndërtimin e një shkolle të re në Kaçanik

Kaçanik, 19 korrik (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, së bashku me kryetarin e komunës, Besim Ilazi, të parin e Nismës në Kaçanik, Agim Çaka, deputetë dhe zëvendësministra të kësaj zone, morën pjesë në vënien e gurthemelit për ndërtimin e një shkolle të re në Kaçanik. "Mbi një milion euro për një shkollë moderne në Kaçanik. Vënia e gurthemelit për ndër-

timin e një shkolle të re është lajmi më i mirë që i kemi dhënë sot fshatit Doganaj të Kaçanikut. Bashkë me kryetarin e komunës, z. Besim Ilazi, të parin e Nismës në Kaçanik, z. Agim Çaka, deputetë e zëvendësministra të kësaj zone, morëm pjesë në këtë ceremoni festive për Shkollën Filllore 'Ali Asllani', ka shkruar Bytyqi në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se ky nuk është vetëm një

premtim i realizuar, por është edhe obligim si MASHT pasi janë zotuar për të investuar në objekte moderne në funksion të ngritjes së cilësisë në arsim. "Angazhimi ynë i sinqertë, çdo ditë, në çdo vend të Kosovës, po jetësohet dhe po jep frytet e saj. Si ministër i Arsimit në asnjë moment nuk do të ndalem së angazhuari për t'i jetësuar të gjitha zotimet e bëra për një arsim më të mirë në Kosovë", ka thënë ministri Bytyqi.



Bëhet thirrje që të ketë trotuare të qasshme për të gjithë

Gjakovë, 19 korrik (ER) - "EC Ma Ndryshe", në bashkëpunim me "Hendikos"-in dhe KVRL në Gjakovë, të enjten kanë realizuar performancën publike "Trotuare të qasshme për të gjithë", përmes të cilit aktivitet kanë reaguar ndaj neglizhencës dhe pasivitetit të autoriteteve komunale për ndërmarrjen e masave adekuate për sigurimin e lëvizjes së lirë në trotuaret dhe rrugët kryesore të qytetit të Gjakovës për personat me aftësi të kufizuara. Përmes këtij aktiviteti, në mënyrë simbolike, përkatësisht duke bërë intervenime në një pjesë të trotuareve në rrugën "UÇK", është theksuar

e drejta e PAK-ve për qasje dhe lëvizje të lirë dhe më të sigurt brenda zonës urbane. Në hulumtimet e "EC"-it, "Handikos"-it dhe të organizatave të tjera që merren me këto çështje, vitet e fundit qytetarët kanë veçuar si njërin prej shqetësimeve kryesore çështjen e lëvizjes së lirë në trotuare, që duhet të ketë një adresim nga institucionet përgjegjëse. Nëpërmjet këtij aktiviteti u bëhet thirrje institucioneve përgjegjëse për t'u angazhuar më shumë duke i ofruar prioritet çështjes së eliminimit të pengesave dhe krijimit të kushteve për këtë kate-

gori. Performanca publike "Trotuare të qasshme për të gjithë" është realizuar në kuadër të projekteve "Qytetet gjithëpërfshirëse" - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje, financuar nga Olof Palme International Center mbështetur nga Qeveria e Suedisë si dhe nga projekti 'Përkrahja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë', financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).



Komuna e Mitrovicës së shpejti do ta bëjë vendosjen e semaforëve të rinj

Mitrovicë, 19 korrik (ER) - Komuna e Mitrovicës gjatë këtij viti do të realizojë një ndër projektet më të mëdha në infrastrukturë: vendosjen e semaforëve. Semaforët do të vendosen në tri pikat më kryesore të qytetit, tek ish-hotel "Adriatiku", vendkalimi i hekurudhës (rruga 'Shemsi Ahmeti') dhe Stacioni i Autobusëve.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Naser Muja, ka bërë me dije se vendosja e semaforëve në Mitrovicë ka qenë prioritet i DSHPI-së që prej ardhjes së tij, pasi që ata semaforë janë të viteve '90-ta dhe nga atëherë nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim në këtë drejtim. "Një ndër projektet më me rëndësi në qytet tani është vendosja e



semaforëve. Kanë qenë disa semaforë të vjetruar dhe kanë qenë shumë të nevojshëm. Janë

tri pika në fillim dhe në të ardhmen besoj se do të vendosen edhe në pika të tjera, sipas nevo-

jës", ka thënë drejtori Muja. Po ashtu, Muja ka theksuar se vlera e këtij projekti kushton rreth

170 mijë euro dhe se implementimi i këtij projekti të rëndësishëm së veçantë për komunikacionin rrugor në këtë qytet ka filluar në këtë vit, por do të vazhdojë edhe në vitin tjetër. "Projekti në total është 170 mijë euro. Për këtë vit janë 90 mijë euro të parapara, ndërsa vitet e tjera është projekt që do të bëhet vendosja e semaforëve, në të njëjtën kohë kompania që e ka fituar tenderin do ta bëjë edhe mbikëqyrjen brenda tre vjetëve. Nuk do të ketë mjete shtesë gjatë mbikëqyrjes së këtij projekti", ka thënë Muja.

Sipas Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, shumë shpejt pritet që këta semaforë të vendosen, ku do të jetë një lehtësim i madh për qarkullim të automjeteve dhe të qytetarëve.

Komuna e Deçanit organizon aktivitetin tradicional 'Dita e qethjes së deleve 2019'


Deçan, 19 korrik (ER) - Sot (e shtunë) në kuadër të aktiviteteve "Ditë e Diasporës 2019" Komuna e Deçanit, në bashkëpunim me Grupin Lokal të Veprimit (GLV) "Gjeravica", organizojnë aktivitetin tradicional "Dita e qethjes së deleve 2019".

I pranishëm në këtë aktivitet do të jetë kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, përfaqësues të Ambasadave nga Shqipëria dhe Mali i Zi, deputetë, zyrtarë dhe qytetarë. Kjo festë gjithmonë ka qenë tra-

ditë dhe çdo vit organizohet me qëllim që t'i bashkojë të gjithë qytetarët dhe bashkatdhetarët e Komunës së Deçanit për të festuar, duke promovuar kulturën dhe traditën tonë. Aktiviteti fillon në orën 10:00, në bjeshkën e Strellcit, te "Stanët e Shalës".



Forca e fushave magnetike jashtë poleve të magneteve



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Përfundim

Intensiteti i fushës magnetike ((B)) ? te të gjithë trupat qiellorë duke e përfshirë Tokën, Diellin, Jupiterin, Saturnin, Uranin, Neptunin dhe të gjithë trupat e tjerë qiellorë që kanë një fushë magnetike dhe ndodhen në Univers është dhjetëra, qindra apo mijëra herë më i madh në hapësirën në mes poleve magnetike dhe elementeve të hekurit (Fe) që i mbulojnë ato pole. Në këtë mënyrë nëpër cilindrin magnetik të tokës, diellit dhe të gjithë trupave qiellorë qarkullon një fushë magnetike me një intensitet ekstrem e lartë.

Eksperimenti 7

E marrim të njëjtin magnet cilindrik dhe e kthejmë në formë horizontale si në Figurën 25, dhe në mes të magnetit e vëmë në kontakt një sferë në të cilën është e varur një enë përmes një litari, për vendosjen e masave për të kryer eksperimente.

Eksperimentalisht shohim se sfera shkëputet nga mesi sapo të varim në të masën prej 225 gramë. Prandaj mund të themi se forca tërheqëse e sferës dhe e mesit të magnetit është rreth 2.2 N. (shih figurën 25)

Përfundim

Sikur te trupat qiellorë qoftë te toka, dielli..., të ekzistonte vetëm një fushë e pastër magnetike ((B)) ?, që do të buronte drejtpërsëdrejti nga polet magnetike të këtyre trupave qiellorë, atëherë kjo forcë në bashkëveprim me forcën gravitacionale do të tërhiqte çdo trup rreth vetes, të gjithë trupat te të cilët do të ishte prezentë fusha magnetike apo materiale ferromagnetike.

Zbritja e intensitetit të fushave magnetike

Eksperiment 8

Nëse tani polet magnetike të magnetit të njëjtë cilindrik, i mbulojmë me pllakë të hekurit (A B), do të shohim se intensiteti i fushës magnetike në mesin e magnetit zbrit nga 210 mT në 85 mT. Për dallim nga rasti i mëparshëm tani sfera e hekurit (Fe) shkëputet nga mesi i magnetit sapo të varim masën e 25 gramë. Prandaj forca tërheqëse në mes sferës dhe mesit të

cilindrit magnetik zbrit nga 2.2 në 0.25 N (shih figurën 26). Nëse e llogarisim në formën më të thjeshtë, do të shohim se fusha magnetike zbrit përafërsisht 2.5 herë kurse forca tërheqëse zbrit për nëntë herë pasi t'i vendosim pllakate hekurit (Fe) (A -B).

Përfundim

Intensiteti i fushës magnetike jashtë poleve magnetike (N S) te trupat qiellorë qoftë te toka, dielli..., zbrit atëherë dhe vetëm atëherë kur polet magnetike të atij trupi qiellor janë të mbuluara me materiale ferromagnetike.

Kjo na jep të kuptojmë se sikur polet magnetike të Tokës të mos ishin të mbuluara me materiale ferromagnetike, intensiteti i fushës magnetike do të ishte dhjetëra apo qindra herë më i lartë, me çka do ta pamundësonte jetën e njeriut mbi sipërfaqen e tokës.

Për të kuptuar më mirë se pse ndodhin këto fenomene të rritjes, apo zvogëlimit të intensitetit të fushës magnetike në polet magnetike (N S) në rastin kur i vendosim pllakat e hekurit (Fe), kurse pse zbrit intensiteti i fushës magnetike në mes të magnetit cilindrik, duhet hyrë në strukturën e brendshme të pllakave të Hekurit (Fe), se çfarë ndodhë gjatë procesit të magnetizimit të këtyre pllakave.





Procesi i magnetizimit të materialeve ferromagnetike

Fenomeni i magnetizimit është një proces shumë i komplikuar, por për ta kuptuar më mirë originën e këtij fenomeni, një përshkrim mikroskopik është i domosdoshëm.

Të gjitha materialet përbëhen nga atomet, kurse atomet përbëhen nga bërthama e atomit, në të cilën hyjnë protonet dhe neutronet, ndërsa elektronet rrotullohen rreth bërthamës së atomit.

Elektronet kanë ngarkesë negative, dhe rrotullohen rreth bërthamës së atomit. Një elektron gjatë një rrotullimi rreth bërthamës së atomit krijon momentin magnetik orbital, kurse gjatë rrotullimit rreth boshtit të vet krijon momentin magnetik të spinin. Spinin mund të jenë të orientuara lart (up) apo poshtë (down), shih figurën 27 a.

Momenti magnetik i atomit është i barabartë me shumën e momenteve magnetike orbitale dhe spine. Këto momente magnetike të elektroneve mund konsiderohen si grimca elementare magnetike. Kurse materialet ferromagnetike



hekuri, kobalti dhe nikeli, përbëhen nga shuma e momenteve magnetike të të gjitha atomeve që e përbëjnë atë material. Në gjendje të lirë këto momente magnetike të atomeve nuk janë të orientuara në të njëjtin drejtim (shih figurën 27 b). Kurse, në rast se këtij materiali ferromagnetik ia ofrojmë një magnetik permanent, momentet magnetike do të orientohen në të njëjtin drejtim, dhe në këtë mënyrë materiali ferromagnetik polarizohet (shih figurën 27 c).

Magnetizimi i pllakave të hekurit mbi magnetin në formë cilindrike

Duke marrë për bazë eksperimentin e mëparshëm numër katër, në rastin kur pllakat e hekurit (A B) i vendosim mbi polet magnetike të cilindrit per-

manent (N S), atëherë momentet magnetike të pllakave të hekurit (A B) do të orientohen në të njëjtin drejtim me fushën magnetike që buron nga polet magnetike (N S) të magnetit në formë cilindrike, dhe në këtë mënyrë pllakat polarizohet (A B) Pas polarizimit, një pjesë e momenteve magnetike nga pllaka e hekurit (A) tërhiqet nga poli magnetik i jugut (S) dhe së bashku me fluksin e fushës magnetike që ishte mbi polin magnetik (S) lëvizin në drejtim të polit magnetik (N), shih figurën 31 a. Në të njëjtën kohë mbi polin magnetik (N) pllaka e hekurit është magnetizuar dhe gjithsesi poli magnetik i veriut (N) i tërheq momentet magnetike nga pllaka (B) në drejtim të polit magnetik (N). Në këtë mënyrë në të njëjtën kohë të dy polet magnetike (N S)

i tërheqin momentet magnetike nga pllakat e hekurit (A B) në drejtim të poleve magnetike (N S). Këto lëvizje të momenteve magnetike që hyjnë në të dy polet e cilindrit magnetik (N S), kanë drejtim të njëjtë dhe kahje të kundër ndërmjet tyre. Në këtë mënyrë, fluksi magnetik brenda magnetit cilindrik qarkullon nga poli magnetik i jugut (S) në drejtim të polit magnetik të veriut (N), kahja e të cilit fluks është e kundër me kahjen e momenteve magnetike që lëvizin nga pllaka e hekurit (B) në drejtim të polit magnetik (N), për shkak të forcës tërheqëse. Kjo kahe e kundërt e lëvizjes së momenteve magnetike shndërrohet në pengesa kryesore të kalimit të fluksit magnetik përtej polit magnetik të veriut (N), shih figurën 28.

Për këtë arsye kemi një rritje të intensitetit të fushës magnetike ((B)) ? në mes poleve magnetike dhe pllakave të hekurit nga 320 mT në 500 mT.

Prandaj fusha e përgjithshme magnetike që hynë në polin magnetik të jugut (S), dhe që kalon nëpër cilindrin magnetik në drejtim të polit magnetik (N), është e barabartë me shumën e fushave magnetike (BNS) dhe (BAB).

$$B = BNS + BAB = 320 \text{ mT} + 180 \text{ mT} = 500 \text{ mT}$$

B fusha magnetike e përgjithshme 500 mT

BNS fusha magnetike e polit magnetik (S) pa prezencën e pllakave 320 mT

BAB kalimi i fushës magnetike nga pllakat e hekurit (A B) në polet magnetike (N S) që ka vlerën e 180 mT.

Kjo fushë e përgjithshme magnetike prej 500 mT qarkullon nga poli magnetik i jugut (S) në drejtim të polit magnetik (N), shih figurën 29 a.

Në momentin kur fusha e përgjithshme magnetike arrin te poli magnetik i veriut (N) mbi të cilin është e vendosur pllaka e hekurit (B) fusha e përgjithshme pothuajse ndalon në përgjithësi. Shkaktar kryesor i ndalimit të pjesës më të madhe të fushës magnetike janë momentet magnetike të pllakës së hekurit (B), të cilat shndërrohen në pengesa për kalimin e tërësishëm të fushës së përgjithshme magnetike (B) prej 500 mT.

Kjo pengesë ndikon në rritjen e pandërprerë të vijave të fushës së përgjithshme magnetike në qendër të magnetit (N S), dhe në mes të magnetit fillon të zgjerohet dhe të del një pjesë shumë e madhe e fushës magnetike.

Pasi kjo pjesë e fushës magnetike ndalon në dalje të polit magnetik të veriut (N), ajo anohet në mes dhe zgjerohet në formë të balonit në të gjitha anët (vijat me ngjyrë të kuqe), shih figurën 29 b. **Vijon.**

Merkeli: Komentet e Trumpit, në kundërshtim me madhësinë e Amerikës

BERLIN, 19 KORRIK - Kancelarja gjermane Angela Merkel i dënoi sulmet verbale të presidentit amerikan Donald Trump kundër katër kongresisteve me ngjyrë, duke thënë se ato "janë në kundërshtim me atë që e bën Amerikën madhështore". "Unë distancohem fuqishëm nga sulmet dhe shpreh solidaritet me gratë", tha Merkel në një konferencë me gazetarë në Berlin. "Sipas mendimit tim, forca e Amerikës qëndron në atë se

njerëzit me origjinë të ndryshme kontribuojnë në madhësinë e vendit", shtoi Merkel. Të dielën Trumpi u tha katër kongresisteve amerikane - që të gjitha qytetaret e ShBA-së - "të kthehen" në vendet e tyre të origjinës. Edhe pse komentet e tij janë cilësuar si raciste dhe janë dënuar nga Dhoma e Përfaqësuesve në ShBA, Trump i ka përsëritur deklaratat. "Nëse nuk jeni të lumtura këtu, ju mund të largoheni", ka thënë Trumpi të martën.

Deklaratat e tilla kundër kongresisteve Alexandria Ocasio-Cortez, Ilhan Omar, Ayanna Pressley dhe Rashida Tlaib kanë nxitur edhe reagim ndërkombëtar. Kryeministrja në largim e Britanisë së Madhe, Theresa May, i ka cilësuar ato si "krejtësisht të papranueshme". Kryeministrja e Zelandës së Re, Jacinda Ardern, ka thënë se ajo "absolutisht nuk pajtohet" me Trumpin. Trumpi ka shkruar në "Twitter" se "nuk ka kockë raciste" në trupin e tij.



A do të ketë sanksione amerikane ndaj Turqisë?

Presidenti Donald Trump tha se Shtetet e Bashkuara aktualisht nuk po shikojnë në drejtim të vendosjes së sanksioneve ndaj Turqisë për shkak të blerjes së sistemeve ruse të mbrojtjes ajrore

WASHINGTON, 19 KORRIK - Autoritetet turke kanë arsye të ndihen të lehtësuara. Tash për tash Shtetet e Bashkuara nuk po planifikojnë sanksione ndaj Ankarasë edhe pse ato ishin paralajmëruar për një kohë të gjatë. "Shtetet e Bashkuara aktualisht nuk po shikojnë në drejtim të vendosjes së sanksioneve ndaj Turqisë për shkak të blerjes së sistemeve ruse të mbrojtjes ajrore", tha presidenti i ShBA-së, Donald Trump. Megjithatë, ai nuk e përjashtoi mundësinë që të ndodhë diçka e tillë.

Vlera e monedhës turke shënoi ngritje menjëherë pas deklaratave të Trumpit. Blerja e sistemit rus të mbrojtjes raketore nga ana e Ankarasë ka zemëruar Uashingtonin dhe thirrjet e njëpasnjëshme për të hequr dorë nga këto plane, nuk patën sukses. Një pjesë e këtij sistemi ka mbërritur nga Rusia në Turqi. Shtëpia e Bardhë, disa ditë më parë, njoftoi se pjesëmarrja e Turqisë në programin e furnizimit me aeroplanë ushtarakë amerikanë F-35 është e pamundur për shkak të

instalimit të sistemit rus. Shtetet e Bashkuara thonë se sistemi rus paraqet rrezik për aeroplanët ushtarakë amerikanë. Edhe aleatët e tjerë të NATO-s i kanë tërhequr vërejtjen Turqisë se sistemi rus paraqet rrezik për pajisje ushtarake të NATO-s. Por, në Shtetet e Bashkuara ekziston një ligj i cili parashih sanksione ndaj shteteve që bëjnë biznes me Ushtrinë e Rosisë. Dhe, pikërisht në këtë ligj po thirren disa ligjvënës republikanë dhe demokratë të cilët po kërkojnë që administrata e ShBA-së të vendosë sanksione ndaj Ankarasë. Senatorët republikanë, Rick Scott dhe Todd Young, paraqitën një rezolutë që bën thirrje për sanksione, pasi Ankaraja javën e kaluar filloi pranimin e një sistemi të avancuar të mbrojtjes raketore të Rosisë. Një senator tjetër nga kampi demokrat Bob Menendez tha se kjo masë ndaj Turqisë nuk është e mjaftueshme. "Ligji në mënyrë të qartë parashikon sanksione për 'transaksione të rëndësishme' me sektorët e mbrojtjes dhe inteligjencës së



Federatës Ruse", tha ai në një deklaratë me email, raporton "Reuters". Agjencia "Reuters" shkruan se rezoluta e senatorëve bën thirrje që administrata Trump të thërrasë bisedime në NATO, për të diskutuar lidhur me kërcënimet e paraqitura nga Rusia dhe për ta shqyrtuar përfshirjen e Turqisë në NATO. Retorika ndërmjet dy vendeve lidhur me këtë çështje ka qenë mjaft e lartë gjatë muajve të kaluar. Ndihmësekretarja amerikane e Mbrojtjes, Kathryn Wheelbarger, pati thënë se blerja e sistemit të raketave S-400

nga ana e Turqisë do të kishte një efekt "shkatërrues" për raportet e saj me aleatët e tjerë të NATO-s. Ministri i Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu, u kundërpërgjigj se "se askush nuk mund t'i japë ultimatume Turqisë". Krahas kësaj retorike mes zyrtarëve amerikanë dhe atyre turq, presidenti amerikan Donald Trump ishte më i butë në deklaratimet e tij dhe disa ditë më parë tregoi edhe "fajtorin" për këtë situatë. Ai është paraardhësi i tij, Barack Obama. Në kohën kur Obama ishte president, Turqia kishte kërkuar ta blejë sistemin amerikan të

mbrojtjes raketore të quajtur "Patriot", mirëpo procesi i shitjes kishte shënuar ngecje. Më pas Turqia ishte orientuar kah Rusia. Kjo, sipas presidentit Trump, ka bërë që tash të bëhet e pamundur edhe shitja e aeroplanëve amerikanë në vlerë miliardë dollarësh autoritetëve turke. Pavarësisht prej mospajtimeve për një gamë të gjerë çështjet, raportet ndërmjet presidentit Trump dhe atij turk Rexhep Tajip Erdogan, të paktën gjatë paraqitjeve publike kanë qenë të mira. Ata disa herë e kanë quajtur njëri-tjetrin si miq të mirë.

Gjykata shpall Holandën pjesërisht fajtoare për masakrën e Srebrenicës

HAGË, 19 KORRIK - Një gjykatë e lartë holandeze ka mbështetur një vendim se Holanda ishte pjesërisht përgjegjëse për 350 vdekje në masakrën e Srebrenicës në Bosnjë e Hercegovinë, në korrik të vitit 1995. Gjykata tha se shteti kishte përgjegjësinë 10 për qind, pasi kjo ishte shkalla e mundësisë, që ushtarët holandezë mund t'i kishin parandaluar vrasjet. "Nëse forcat holandeze u

dhanë mundësi këtyre burrave të qëndrojnë aty, ka pasur vetëm 10 për qind mundësi që ata të mos bien në duart e forcave serbe dhe për këtë arsye shteti holandez duhet të jetë përgjegjës vetëm për atë pjesë të dëmit", vendosi Gjykata. Një gjykatë e apelit kishte caktuar përgjegjësinë më herët në 30 për qind, por vendimi i Gjykatës Supreme ka ulur në mënyrë drastike këtë shifër. Forcat serbe të Bosnjës vranë

rreth 8 000 burra myslimanë në qytetin e Srebrenicës më 1995. Holandezët po ruanin një zonë të sigurisë të OKB-së kur ndodhi ngjarja. Është e rrallë për një shtet që të mbahet përgjegjës për dëshimet në punën paqeruajtëse të OKB-së. Në vitin 2002, një raport për rolin e Holandës në Srebrenicë bëri që e gjithë Qeveria holandeze ta japë dorëheqjen.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Holanda mbjell lule në stacionet e autobusëve

Këshilli Bashkiak i Utreht në Holandë mbolli bimë dhe lule në çatitë e qindra stacioneve të autobusëve si dhuratë për bletët. Bëhet fjalë për sedum (plantacion i bimëve), ndërsa u vendos të mbulohen



kulmet e 316 stacioneve të autobusëve.

FOTO E DITES



Një vepër arti e krijuar nga artisti i peizazhit Steve Messam në Angli. Fotografia: Christopher Thomond. /The Guardian/

E rrallë

Festoi ditëlindjen e 100 duke u hedhur me parashutë nga aeroplani

Thomas Hodgson nga Cumbria e Anglisë, e ka festuar ditëlindjen e 100, duke u hedhur me parashutë nga aeroplani, 74 vjet pasi u lëshua për herë të fundit, gjatë Luftës së Dytë Botërore. "Jam kënaqur aq shumë sa që fjalët nuk e përshkruajnë. Më solli kohën e luftës, por këto mendime i largova menjëherë", ka thënë Hogson pasi aterroi me sukses.



BARSOLETA E DITËS



- Pse biondina e mban një gotë të thatë në frigorifer?
- Sepse kur i vjen një mysafir dhe biondina e pyet: 'Çfarë doni të pini?', e mysafiri i thotë: 'Kurrëgjë, faleminderit!', biondina ia sjell gotën e thatë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00
"X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg



Në ora 20:00

"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray



Ne ora 22:00
"M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown
Regjia: Tate Taylor




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI
Sot planetët i keni në anën tuaj dhe ju premtojnë një fillim dite të mbarë. Gjithsesi duhet të lini më shumë hapësirë për jetën familjare.



DEMI
Një dëshirë e madhe për normalitet dhe për projekte konkrete. Ka ardhur momenti të mendoni një zgjidhje më të përshtatshme për veten.



BINJAKËT
Çdo dëshirë e juaja është një urdhër në këtë periudhë, thjesht duhet ta përmirësoni disi mënyrën e të kërkuarit të gjërave.



GAFORRJA
Keni lënë shumë gjëra pezull dhe nuk po gjeni dot mënyrën për t'u organizuar. E gjithë kjo situatë do t'ju penalizojë.



LUANI
Momentet e vogla të kënaqësisë sot janë ato që do ta bëjnë dallimin në rutinën e ditës dhe që do t'ju japin energji pozitive.



VIJGJËRËSHA
Nuk dini të gënjeni kështu që gjatë drekës duhet t'u jepni përgjigje të sakta personave që do të kërkojnë informacion nga ju.
PESHORJA



Keni çështje
burokratike ose administrative për të zgjidhur sot. Mos humbni kohë duke kërkuar zgjidhje vërdallë, e dini se çfarë duhet të bëni.



AKREPI
Eprorët tuaj kanë filluar të dyshojnë nëse jeni vërtet i aftë ta bëni punën. Kjo si pasojë e disa vonesave të vërejtura kohët e fundit.



SHIGJETARI
Ndryshojeni ritmin e ditës duke organizuar një takim me miqtë, një film në kinema ose diçka tjetër të këndshme.



BRICJAPI
Mposhteni shumë shpejt nga emocionet dhe kjo gjë nuk ju lejon që ta shihni realitetin që ju ofrohet. Duhet të logjikoni në mënyrë racionale.



UJORI
Personat që ju kanë pezmatuar do t'i nxirni përfundimisht nga jeta juaj. Jeni drastik në marrjen e vendimeve, por kjo ndodh veç kur lëndoheni.



PESHQIT
Sot do ta keni mendësinë të balafaqoheni me një person me të cilin keni debate të vazhdueshme. Do të sqaroni shumë gjëra.

Transformimi i Drake ndër vite



Drake mund të jetë një nga reperët më të njohur në botë, por nuk ishte gjithmonë kështu. Për Aubrey

Graham ishte një udhëtim i gjatë për të qenë Drake të cilin miliona njerëz e adhurojnë sot. Por ai ndër vite ka bërë transformim.

Hailey largohet nga sfilatat?



Apo pensionohet Hailey Bieber nga të qenit modele sfilatash mode? Kështu duket nga një postim që ajo e bëri në "Instagram". Modeluesja 22-vjeçare e ka postuar në "Insta Story" një fotografi të saj të shkëputur nga sfilata e Zadig dhe Voltare vjeshtë-

dimër 2018. Fotografia e tregonte krahun e saj që lëkundet. Hailey e ta titulluar foton: "Ajo që unë e di është se krahu juaj nuk do të duhej të lëkundej ashtu në një sfilatë mode, prandaj kjo nuk është dhe nuk do të jetë më gjëja ime përsëri", ka shkruar modeluesja.



Angelina dhe e vogla e saj të buzëqeshura ecin së bashku në Los Angeles

Angeline Jolie dhe vajza e saj 11-vjeçare Vivienne Jolie-Pitt nuk duken vetëm të njëjta, por edhe vishen njëjtë. Nëna dhe bija u panë së bashku të veshura në të bardhë derisa po shkonin në një

dyqan për kafshë. Ato të dyja patën një ditë të vajzave më 17 korrik dhe bënë një mik speciale: një lepurush. E vogla e Angelinës doli nga dyqani me vrap, e gëzuar me lepurin në dorë.

Jennifer Hudsoni arrin marrëveshjen e kujdestarisë për djalin




Jennifer Hudson ka arritur një marrëveshje kujdesi me ish të fejuarin David Otunga, dy vjet pas ndarjes së tyre. Aktorja, fituese e çmimit Oskar, 37 vjeçe, dhe 39-vjeçari, ish-profesionisti i mundjes,

filluan një betejë të kujdestarisë ndaj djalit të tyre David Jr, pothuajse dy vjet më parë, me Tribunalin e Çikagos që raportojnë se palët arritën marrëveshjen e tyre të martën.

SHKRIMTARI PËRBALLË DIKTATURËS (4)

Kur e kaloi Kadare

Përsiatje rreth librit të shkrimtarit Ismail Kadare, “Kur sunduesit grinden”



Bedri ISLAMI

Është e pashmangshme që në një ditë ose në një tjetër sunduesi i pushtetit me sundimtarin e mendjes do të ndeshen. Mund të vonojnë, por është e pashmangshme. Përballa e tyre mund të vijë, në pamjen e parë, për shkaqe krejt mediokre, por akujt e nënujshëm kanë nisur prej shumë kohësh të shkrihen dhe kanë pritur një moment të caktuar që të fillojnë një lëvizje të ububushme. Ose, ata mund të shfaqen në formën e përplasjeve tragjike, të një plenumi, mos. Oh Zot, plenumi i katërt, i një përmasë krejt ndryshe, por në të gjitha rastet, ajo që nxit këtë ndeshje, shpeshherë të padukshme fillimisht, është mëria e vjetër e sunduesve të shtetit, në fakt, të diktatorëve me sundimtarët e mendjeve. Mëria e hapësirave. Jo më kot Stefan Cvajk do të shkruante se një poet në Weimar, Gëte, zotëronte jo më pak hapësirë se Napoleoni me armatën e tij.

Të paaftë për të qenë zotërues të mendjes, që do të thotë pushtetarë mbi shpirtin, ndjenjën e të bukurën, sunduesit kanë kurdoherë të ngritur shqisën kundërshtuese të rivalit të tyre të pashallur; pikërisht të atij që ka menduar kurdoherë se është rob i tij, kurse në të vërtetë, me kalimin e kohës e ka mësuar të vërtetën se, jo vetëm nuk mund të robërohet mendja, shpirti, ndjenja, arti, por edhe ai vetë, duke dashur ta zotërojë, e ndjen se po bie nën pushtetin e saj. Çka është e papërballueshme për çdo lloj tirani.

Diktatura dhe arti ka qenë kurdoherë një temë e dashur për Ismail Kadarenë dhe asaj i është kthyer e rikthyer jo vetëm pas vitit 1990, por edhe shumë kohë para saj. Natyrisht ai nuk ka bërë harakiri, por duke u futur në grimasat që lejonte pushteti, ai ka gjetur mundësinë për të ngjizur hapësirat e tij, kurdoherë fine dhe

në një përmasë poetike që vijonte të rritej, të bëhej e dukshme, e kapshme, shqisë njerëzore dhe që, më në fund, merrte të drejtën e kuptimësisë.

Gjithsecili krijues ka Rubikonin e tij, po ashtu si mund të ketë edhe Vaterlonë e tij. Ai është përherë i dyzuar mes shkëmbinjve, por që të ndjejë këtë, në radhë të parë duhet të jetë një krijues i madh. Secili nga autorët e mëdhenj të letërsisë botërore ka çastin e tij të prehjes. Edhe etërit e saj. Horaci ka thënë: “I miri Homer dremit ndonjëherë”.

Borges besonte tek vija spirale e Gëtes. Ne ecim përpara dhe tërhiqemi, por në fund të fundit bëhemi më të mirë.

Kalimi i Rubikonit është ai që i përcakton të ardhmen e një krijuesi.

Kur e kaloi Kadare rubikonin e vet?

Nuk mendoj se ka një datë të caktuar, një moment të veçantë apo ka rendur pas një tërthoreje ndryshe.

Kadare që në fillimet e krijimit të tij të kësaj bote kadareane ishte i kundërt në gjithçka me shkrimtarin e përfytyruar të realizmit socialist.

Asnjëherë realizmi socialist nuk do të kishte në Shqipëri, përballë pasqyrës së tij, një shëmbëllim kaq ndryshe, të pakontestuar, që, ndonëse e kishte thirrur në ndihmë si xhindin e llambës magjike, ai nuk do të bëhej njeriu i futur në shishe apo autori në këllëf.

Thuajse i vetëdijshëm, ai i shmangej kufirit të asaj që ndilte realizmi socialist, ai kishte në vete atë parandjenjën e frikshme se mos takimi i dy botëve dhe i dy perceptimeve, ajo e krijuar nga vetë ai, ende paradigme, me atë tjetrën, do të sillte mpirjen, dhe kjo do të ishte e dhimbshme.

Nëse realizmi socialist kërkonte besnikërinë ndaj revolucionit dhe kthimin e shkrimtarëve në ndihmësit dhe besnikët e partisë, ai njehtë në fakt pushtues të tjerë të botës, krijon perandorinë e tij vetjake, disi naive fillimisht në fëmijërinë e tij, në atë qytet enigme dhe mister, për më tepër në një rrugë me emrin e pazakontë e të kërkundtë në botë, “Sokaku i të marrëve”.

Çdo libër i Kadaresë, ndërsa ishte gjithnjë e më shumë largim nga realizmi socialist, aq më shumë shkurtrohej rruga e tij, drejt mën-

janimit fillimisht, e pastaj drejt mbylljes, për të shkuar në ngrirje. Rruga e tij shkurtrohej si Lëkura magjike e Shagrenit në novelën mistike të Balzakut.

Kadare e thjeshton botën rreth tij dhe këtë e bën duke i rritur përmasat. E habitshme, por jo e pamundur. Ai e di të vërtetën se Zoti e krijoi botën përmes fjalëve. “Hyji tha: “Le të bëhet drita”.Dhe drita u bë”... Hyji tha edhe: “Le të bëhet ndërmjet ujërave kupa e qiellit dhe le t’i ndajë ato ujërat prej ujërave”...

Në kalimin e parë të Rubikonit ka fatin e pazakontë të gjejë një gjeneral. Për më tepër, një gjeneral të ushtrisë së vdekur. Më pas i dërgon personazhet e tij tej në botë, fillimisht në Francë, kështjella e dikurshme e Hoxhës, dobësia e tij, që, edhe e qasi, edhe e largoi. Si do e priste shemrin e tij, nga i njëjti qytet, nga e njëjta rrugë?

Pastaj personazhet përhapen nëpër botën e madhe, herë-herë si shtergë të vetmuar, herë-herë si çudia të një bote që nuk ishte njohur. Zbulon enigmën e një vendi nën akullin e idomës komuniste, por pa e shkruar atë, shemb një mur, por pa i ngritur themelet një tjetri; nuk ka pasur prirje të tij, vendi i panjohur dhe letërsi e panjohur nuk thonë asgjë në pragardhjen e tij; i duhet vetë të fitojë karrigen e tij.

Vëzhgues i jashtëzakonshëm, megjithëse i ftohtë, konservon gjithçka brenda vetes në atë kujtesë që nuk do të plakej nga vitet e nuk do të dëmtohej nga rrebeshi i kohës.

Shpesh herë më është dukur se Kadare as nuk i do dhe as nuk i urren personazhet e tij. Ata janë gjendje. Vetëm një herë ai del nga kjo “gjendje” e ngritur nga ai dhe atë herë nuk bën një mrekulli letrare, por një shabllon kohor, që i ngjan në shumë kahe asaj që nuk e kishte pasur e nuk do e donte më. Romani “Dasma”, ndërsa lartësohej si “hymn i klasës punëtore”, do të ishte në fakt fillimi i Vaterlosë së Kadaresë, nëse nuk do të kryengriteshin qelizat e tjera të magjisë së tij letrare, nëse në vetëdijen e tij krijuese të mos ngrihej mendimi se, nuk mund që gjërat e lëvizshme, të përkohshme të kenë njëkohësisht edhe vlera të qëndrueshme. Në pak kohë ai fiton një popullaritet të pamatë. Librat e tij priten me padurim dhe çfarë është më e çuditshme, priten padurueshëm edhe nga ata që janë jashtë, pra në palirinë e lirisë së tyre, por edhe nga ata që janë brenda, pra të lirë në palirinë e tyre, të burgosur. Nga këto të fundit edhe më shumë, së bashku me padurimin e pritjes së çastit kur shkrimtari i madh do të jetë mes tyre.

Duke risjellë në 13 variante të misterit e telefonatës mes Stalinit dhe Pasternakut, si dy skaje të një litari, Ismail Kadare përsiat atë që në të vërtetë ka ndodhur edhe në Shqipëri, në kthinat dhe skutat e asaj që quhej Lidhja e Shkrimtarëve, nga të cilat vetëm pjesëza e parë, “Lidhje”, të kujtonte atë që do të ndodhte më pas me mjaft kolegë shkrimtarë, lidhjen e tyre përmes prangave, por edhe përmes një procesi inkuzional të pamatshëm me botën tjetër të artit, qoftë edhe në vendet simotra komuniste. Këtë Lidhje, poeti Frederik Reshpja do e quante Shtëpia Kriminolo-Letrare e Partisë së Punës.

Në Shqipëri prej kohësh ishin zhdukur ikonat letrare, mjaft nga ata që kishin argjenduar, tashmë ishin në heshtje; pushteti kishte qenë i ashpër mbi veprën e tyre dhe shpesh herë kjo kishte rrjedhur nga jeta, e pak herë nga fjala e shkruar. Shkrimtarët e njohur, si të thuash, ishin hirmosur; ata që do të zinin vendin e tyre ishin ende të pluhurosor nga cektina e talentit dhe nga shkrepitja e luftës të sapo mbaruar që u kishte mbetur në mendje. Të paktët si Shuteriqi, Spasse apo Xoxa, Petro Marko apo Mitrush Kuteli, në këtë rrëmujë të madhe, nuk arrinin dot të ngrinin një peshë kaq të rëndë të artit, për më tepër, ajo që u kërkohet, realizmi socialist, ishte i papritur, stresues, e herë-herë, i papërballueshëm.

Kadare, përmes enigmës misterioze të një bisede telefonike, që nuk ishte kurrë vetëm aq, do të sjellë shemrimin e vjetër sa bota mes “princit” të shndërruar në “prijës”, “udhëheqës i madh”, “timonier i madh”, dhe sundimtarit të mendjes, krijuesit, të kudogjindshmit; dhe këtë, jo vetëm në sinoret e mëdha të një të gjashtës së botës, në kontinentin aziatik, por edhe në këtë ngrehinë të vogël shqiptare, ku dramati dhe tragjeditë do të jenë po aq të mëdha, në mos edhe përtej tyre.

Duke perfrazuar Jorge Luis Borges, koha ose jeta për shkrimtarët shqiptarë ishte e dyllshme: me ose pa diktaturën. Befas, pas vitit 1945, Shqipëria ishte egërsuar, kur pritej të zbutej. Po ndjehej mungesa e hapësirës, aq e domosdoshme për shkrimtarët. Jepte një frymë të lehtë qetësimi përbërja e kryesisë së parë të Lidhjes së Shkrimtarëve, ku mes të tjerëve do të ishte edhe Vinçens Prendushi apo Sejfulla Malëshova, dy poetë që cilësoheshin krejtësisht të kundërt në jetën e tyre, por që po provonin bashkëjetesën. Prendushi ishte prift, Malëshova komunist i vjetër; Prendushi ishte adhures i



traditës së vjetër zakonore dhe poezia e tij mbështetej tek kjo rrymë, Malëshova ishte revolucionar, përmbysës, pasues i Avni Rustemit dhe sekretar i Fan Nolit. Në mes njërës, si pjesë e elitës së shërbimit të krishterë katolik, dhe, tjetrit, si pjesë e nomenklaturës së lartë të shtetit komunist, paqja do të ishte më e shkurtër se sa marrëveshja. I pari do të burgosej Prendushi, që do të vdiste në burg; më pas, rradhën do e kishte Malëshova, ndoshta i vetmi nga antarët e rëndësishëm të udhëheqjes komuniste që do të vdiste në internim, pasi të tjerët, pas tij, kur shteti do të egërsohej edhe më, do të pushkatoheshin.

Zanafilla e Golgotës shqiptare të artit nis kështu.

“Kur sunduesit grinden”, megjithë hapësirën e madhe që zë në deshifrimet e pafund, hamendjet, përplasjet, studimet, marrjen me të mirë apo me të keq të poetit, nëse do të krahasohej me jetëshkrimin e njërës nga poetët e dënuar politikë në Shqipëri, do të ishte e pangjashme, pasi, qoftë dënimi, qoftë pasdënimi, do të ishin më të stërmëdha.


Ashtu si Mandelshtami, poetët shqiptarë të arrestuar dhe të dënuar, nuk u kryqëzuan për veprën e botuar, por për atë të pabotuar.

Shkaku është i thjeshtë: askush nuk e lejoi botimin e tyre.

Nëse censura ruse kishte dy palë sy, ajo në Shqipëri kishte njëqind palë të tillë.

Nëse censura ruse ishte e fuqishme para botimit, në Shqipëri ajo do të vazhdonte

Rubikonin e tij?



edhe pas publikimit të librave, sidomos pas tyre.

Megjithëse nuk kishte shenja të disidencës së hapur, edhe aludimi përbente faj, ishte objekt gjykimi, mbledhesh të pafund dhe çastesh denigruese. Në Shqipëri, si konstaton me të drejtë studiuesi Shaban Sinani, kishte shkrimtarë të padënuar (të paburgosur) me vepra të dënuara. Rasti më tipik i kësaj kategorie është Ismail Kadare. Shprehur me fjalët e njërit prej funksionarëve më të lartë të Partisë së Punës për ideologjinë, që gjenden në një procesverbal të mbajtur në vitin 1985, "asnjë vepër e Ismail Kadaresë nuk i ka shpëtuar dënimit".

A ka qenë Ismail Kadare një shkrimtar desident?

Kjo është njëra nga pyetjet që është shtruar në dy kohërat: në atë para vitit 1990 dhe në atë pas këtij viti.

Interesant është fakti se disidencën e tij e kanë kërkuar dy skaje të shoqërisë, që ishin në përleshje me njëra tjetrën: njerëzit e sigurimit të shtetit dhe kjo është në shumë nga materialet e dosjes së Kadaresë, dhe, nga ana tjetër, të burgosurit politikë të kohës.

Të parët, si ndodh rëndom, për ta mbajtur nën frerin e tyre dhe, ndoshta, për të gjetur momentin e dënimit të tij; të tjerët, për të gjetur atë që i mungonte, fillimin e rebelimit të një plejade tjetër, ndryshe nga ajo që kishte pasur kokën mbi supe në vitin 1945.

Diskutimet janë ndezur edhe më shumë pas vitit 1990. Janë hedhur hipoteza, kundërshti, është gërmuar në libra, janë dhënë

kuptime të ndryshme, janë kthyer përmbys çaste e hapur dosjet e vjetra, janë ngjallur meritë dhe hesapet e të shkuarës, janë nxjerrë nga defterët e vjetër gjithfarë shënimesh dhe dëshmish, janë sjellë alternativa dhe përsiatje, është synuar të deshifrohet ftohtësia e tij dhe janë përmbysur në fragmente letrash.

Të dukej sikur bota ishte kthyer përmbys. Tani, ish-sigurimsat, të pahumbur si mendohej, shtjellonin tezën dhe e përhapnin furishëm atë, se Kadare nuk kishte qenë asgjë tjetër, veçse poeti i përdhelur i oborrit dhe se, çdo alternativë tjetër ishte e dështuar. Me to ishin bashkuar një tufë shkrimtarësh mediokër të së shkuarës, që mungesën e talentit e lidhnin me kohën e shkuar dhe, në kulmin e hakmarrjes së tyre meskine, donin me çdo kusht të vishnin mantelin e disidentit, ndërkohë që ende në gardërobat e tyre ruanin kostumet e hirtë të realizmit socialist. Këto shkrimtarë mesataristë apo mediokër, deri dje të kënaqur për letërsinë brohoritëse që kishin paraqitur, me vullnet të plotë, si "ndihmës së partisë për edukimin e masave", tashmë kishin gjetur një "brohoritje" të re, synimin për të linçuar atë që e kishin ndjekur nga pas gjithë jetën, me lakminë e të patalentuarit dhe kënaqësinë që u kishte falur përshëndetja e tij në rrugën e kryqëzuar.

Jo çdo kundërvënie, rebelim, papajtueshmëri, mërzi dhe ashpërsim, mund të quhet disidencë. Tek Kadare ka qenë gjithçka e pamatshme: ai ka qenë shkrimtari më i botuar dhe njëkohësisht më i ndaluari. E,

megjithatë, ai nuk ishte disident. Në njërin nga prononcimet e tij, shkrimtari Ismail Kadare është shprehur se "unë kam qenë një shkrimtar normal në një shoqëri jonormale, jo një shkrimtar disident". I lodhur nga mërmërimat, diskutimet pa fund, hamendjet, afrimin e kurorës së disidentit dhe largimin e saj, sidomos në pragun e nominimit për çmimin "Nobel", i bezdisur nga pyetja, nëse ka qenë apo jo disident, ai ka përsëritur se "nuk kam qenë i tillë dhe se ajo që kam bërë s'ka qenë veçse një letërsi normale në një kohë anormale. S'më është dashur dhe as që do më duhej tjetër titull, meritë apo krenari".

Historia e Pasternakut me Stalinin, ajo telefonatë mister e 13 qershorit 1934, që është dukur sikur solli fitoren e tiranit mbi poetin, duke e fajësuar këtë të fundit, është ndër ato që ka vazhduar edhe më tej.

Sado që nuk është dashur kurrë të bëhej e njohur nga shkrimtari Ismail Kadare, përballja e tij me diktatorin shqiptar, ka ndodhur dhe nuk kishte se si të ndodhte ndryshe.

Jo se ata, të dy vinin nga i njëjti qytet dhe nga e njëjta rrugë. Si duket, ata nuk kanë qenë fillesë dhe nuk kishte pse të ndodhte ashtu. Herë pas here, edhe ai ka bërë lëshimet e tij, ato "qokat" e domosdoshme, si një lloj haraçi, i cili duhej të paguhej domosdo. Çuditërisht, këto "qoka" janë më shumë në disa nga poezitë e tij, se

sa në prozën e tij të shumëllojshme.

Mendimi, i lindur pas vitit 1990, se Ismail Kadare është një shkrimtar i klasit të parë, por, ç'e do, i prishin punët ato faqet që kishte shkruar për Enver Hoxhën, zgjohej herë pas here, pa bërë më tej, në atë që vërtet kishte ndodhur.

Romani i Kadaresë "Dimri i vetmisë së madhe", edhe pse është këmbëngulur fort të quhet haraçi i Kadaresë për Enver Hoxhën, në të vërtetë është requime për botën komuniste; është ripërsëritja e Makbethit në një sallë tjetër, shumë më të madhe, është vrasja në gjumë e besimit të njerëzve tek një doktrinë ere, që nga ëndërr po bëhej e përgjakshme, është, në fakt, zezona e kësaj bote.

Ata që e ndjenë më shumë këtë përballje dhe tmerr, ankth e trishtim, përmbysje dhe vrasje, ishin majat e studimit komunist në Shqipëri.

Ata, të parët, kërkuan me ngulm ndalimin e veprës. Mohimin e saj. Kalimin në karton. Furtuna e ngritur kundër veprës u bë aq e furishme, sa që ngatërroi nëpër këmbë anëtarë të Komitetit Qendror, të byrosë politike, komitete të rretheve dhe deri në qendrën fatkobe të shtetit, në Shkollën e Lartë të Partisë, që me një vendim të posaçëm, ishte njerëzuar si shkollë e lartë universitare. Me datë 8 maj 1973, Komiteti i Partisë i Tiranës, i dërgon Komitetit Qendror, Ramiz Alisë, mendimet e shfaqura në organizatën e partisë të pedagogëve të shkollës së partisë "V.I. Lenin" për romanin "Dimri i vetmisë së madhe" të I. Kadaresë.

(Po sjell shkurtimisht shtatë pikat kryesore, duke mënjanuar analizën e tyre)

1. Autori shtrembëron të vërtetën historike...
 2. Situata e brendshme e vendit, marrëdhëniet shoqërore e lufta e klasave gjatë periudhës së bllokadës nuk janë pasqyruar drejt e me vartësi jetësore.
 3. Lufta e klasave pasqyrohet pa vërtetësi dhe nga pozitat e humanizmit abstrakt.
 4. Në vepër përliqet e propagandohet lufta midis brezave.
 5. Sa u përket heronjve, ndihet fryma e deheroizmit. Personazhet negativë janë të shumtë dhe paraqitja e tyre zë vendin kryesor.
 6. Në vepër paraqiten plagë të tilla shoqërore, si alkoolimi, prostitucioni etj.
 7. Veçanërisht ndihet në roman influencimi i autorit nga teoria e sotme borgjeze e "revolucionit seksual" dhe nga filozofia ekzistencialiste...
- Do të ishte mirë që ky roman të hiqet nga qarkullimi.

Historia e ndeshjes së diktaturës me shkrimtarin është e lashtë, sa bota dhe, si duket, do të vazhdojë edhe m tej. Vazhdimi i saj, edhe kur tirania merr fund, është shenja e parë se tirania vazhdon të jetë e pranishme, ajo nuk ka rënë deri në fund dhe se, hakmarrja e saj, sado e vonuar të duket, është pikërisht kundër kësaj letërsie normale të krijuar në një kohë anormale.

Për fat Shqipëria, majat e artit të saj, e krijuan këtë letërsi normale në një kohë anormale.

E krijuan mundimshëm, me vuarjtje, duke lënë në atë betejë të hapur e të ashpër, shumë viktima. Por, nuk doli e mundur.

Mbyllje

Është e vështirë të flasësh për raportet e shkrimtarit me diktaturën, po aq sa është të flasësh për Kadarenë.

Ai ka pasur dhe vazhdon të ketë veçantitë e tij. Do apo nuk do, atë e ndjen deri në brendësi të vetvetes. Edhe kur është inaçi, zezvek dhe njeri që nuk e njeh faljen. Çdo herë, përballë një vepre të kufizuar, ke zbuluar të pakufishmen dhe, përmes abstraktes ke gjetur realen.

Duke perifrastuar Stefan Cvajkun, Kadare është tepër i madh për shikimin tonë të përditshëm.

Kadarenë e duan me të njëjtën forcë të shumësisë njerëzore, që nuk e duan një pakësi e hidhur e botës jashtë letrare.

I paprituri që pritët me ankth. Me Kadarenë, më thoshte një ditë poeti i çuditshëm dhe eruditi i pashoq, Moikom Zeqo, je i sigurt, ai nuk flet pasi t'i kthesh shpinën. I veçantë në jetën e tij, më shumë të përkorë në dukje dhe më tepër vetëtuese në letra.

Kadare është girokastrit. Vlonjati, për shembull, është më vlonjat sesa një girokastrit është girokastrit. Por ky i fundit është më fin, më mondan, i mbajtur me njëren dorë pas traditës dhe me dorën tjetër tejtaj, duke braktisur ngushticat për një gjendje të re.

Askush nuk e përfytyron dot Kadarenë të ulur këmbëkryq, pranë një softe, duke pirë raki, apo duke ia kthyer në një këngë labe, e megjithatë, ai mbetet një ndër shkrimtarët më të dashur, më të njohur dhe më pasionantë të njerëzve.

"Ismail Kadare është ndoshta shkrimtari më i rrallë në botë që del fitimtar mbi diktaturën, pa u shqetësuar të shpallej si disident a kundërshtar i saj.

Kur diktatura ra, shkruan poeti Visar Zhiti, kishte edhe plagët që i bëri asaj shkrimtari".

Një diktaturë me plagët e shkrimtarit, është gjithnjë e humbur. (Fund)

FOTOGAZETARIA E LUFT



SHPRESË MULLIQI

Punimi për këtë temë është bërë i motivuar nga dëshira për ta prezantuar vlerën e fotografisë dhe fotografëve si pjesë e rëndësishme e revistës "Kombi" si dhe vlefshmërinë e tyre si burim për ta dokumentuar një ngjarje historike me rëndësi për kombin shqiptar në përgjithësi, e në veçanti për gazetarinë shqiptare, sepse është revista "Kombi" ajo e cila vuri themelet e asaj që njihet si gazetari e luftës. Ky punim, gjithashtu, mëton ta analizojë nevojën historike për ta dëshmuar krimin dhe përmes tij atdhedashurinë, në të njëjtën kohë të ruhen vlerat njerëzore dhe ato profesionale të gazetarëve.

Natyrisht, si pjesë e kësaj ekipe gazetëbërëse, nuk do të jetë e lehtë të krijohet distanca. Mirëpo, kjo nuk është shkencë matematikore kur çdo gjë funksionon sipas disa formulave të paracaktuara sepse, para së gjithash, ne jemi njerëz dhe, siç thotë dhe Stuart Hall në librin "Përkushtimi i fotografëve të lajmit"¹, ndonjëherë ideologjia e mbisundon vizualen, duke bërë përzgjedhjen e atyre pamjeve të cilat janë në funksion të asaj që konsiderohet se është mesazhi të cilin duam t'i përcjellim opinionit, apo se pikërisht është kjo ajo që opinioni pret nga ne.

Përzgjedhja e momentit, e këtij personi apo atij, e këtij këndi apo atij tjetrit, e këtij incidenti apo atij tjetrit, për ta prezantuar një ngjarje në tërë përbërjen e saj, ka kaluar nëpër një proces të tërë, e që është një procedurë jo vetëm ideologjike por, para së gjithash, profesionale e që, në fund të fundit, ka riprodhuar atë që me të vërtetë ka ndodhur dhe ka sjellë para publikut të gjerë një ngjarje përmes fotografive dhe fjalëve ashtu siç ka ndodhur.

Histori e shkurtër e fotografetarisë

Fotografitë nuk janë evidencë e historisë; ato janë vetë historia.² Nëse mëtojmë që këtë profesion ta shohim nga një këndvështrim shumë i ngushtë dhe i thjeshtë, atëherë do të themi se fotografetari është të rrëfyerit e një ngjarje përmes fotografive. Por, dhe përkundër kësaj, ne nuk duhet të harrojmë se kjo nuk është e tëra, nuk është thjesht vetëm një rrëfim i ngjarjes përmes fotografive sepse, njëkohësisht, është edhe bartje e të së vërtetës. Fotografetaria ofron informata përmes të cilave lexuesi

do ta ketë një pasqyrë të qartë mbi atë se çfarë po ndodhë. Dhe, këtu, mbase dhe nuk do të ishte e tepërt që edhe një herë ta përkujtojmë thënien e vjetër kineze, e cila thotë se "një fotografi vlen sa një mijë fjalë".

Ndërsa fotografetaria e luftës është bërë pjesë përbërëse e jetëve tona që nga Lufta e Parë Botërore, kur dhe u bënë fotografitë të cilat dëshmuar tmerret e luftës dhe pasojat që ajo la në shtete dhe kombe të ndryshme.

vetëm një libër i është kushtuar tërësisht etikës së fotografetarisë, libri *Etika dhe praktikat në gazetari* i Albert Henning³, ku, mes të tjerash, thuhet se fotografët pa hezitim mund të konsiderohen gazetarë dhe se pak redaktorë duhet të kalojnë nëpër shkollat apo përgatitjet në të cilat kalojnë fotografët, për ta përzgjedhur një temë. Kjo nënkupton se fotografët janë ata të cilët, përveç qëllimit të fundit, fotografisë, duhet të kenë parasysh edhe një mori faktorësh

"150 vjet të fotografetarisë" të revistës "Times", në të cilën ekspertët shkruajnë se ka me qindra fotografi të paharrueshme ku janë shënuar "ngjarje të mëdha, imazhe të luftës dhe paqes, të varfërisë dhe të triumfit, janë ato të cilat kanë ngelur në mendjet dhe zemrat tona".⁵ Dhe, si për ironi, tetë nga dhjetë fotografitë të cilat kanë gjetur vend në këtë libër, kanë probleme etike, ku njëra prej fotografive "të paharrueshme" është bërë edhe më e paharrueshme përmes manipulimit kompjuterik. Pastaj, shembulli tjetër është ai i fotografit të Luftës Civile, Alexander Gardner, i cili i ka lëvizur trupat e viktimave⁶ për të ilustruar, në imazhe të ndara, ushtarët e Konfederatës dhe ata të Unionit.⁷

Këtu do të ndalemi për ta ilustruar këtë pjesë me përvojën e revistës "Kombi" dhe të gazetarëve të saj. Fotoreporterët e revistës "Kombi" (e që ishin vetë gazetarët e redaksisë apo bashkëpunëtorët), jo rrallë kanë hasur në pamje përmes të cilave është testuar profesionalizmi i tyre. Nuk duhet harruar se kushtet në të cilat është punuar si dhe pajisjet të cilat janë përdorur në terren lënë shumë për të dëshiruar por, megjithatë, ata nuk janë sfiduar as edhe një herë të vetme që të bëjnë intervenime të tilla të cilat do ta ndryshonin autenticitetin e imazhit, edhe historinë e ngjarjeve.

Gjatë gjithë periudhës sa është botuar kjo revistë të gjitha fotografitë e prezantuara kanë qenë autentike, të marra me pëlqimin e bashkëfolësve, apo në raste të dëshimive të masakrave, kanë qenë brenda kufijve të shijes së mirë, gjegjësisht kanë dhënë imazhe të cilat konsiderohej se mund të plasoheshin në opinion pa i lënduar familjarët e viktimave apo dhe pa cenuar dinjitetin e viktimës, sikur dhe kërkohet me kodin e gazetarëve të Kosovës, apo dhe atë të Shoqatës së Fotografetarëve.⁸ Madje, përpos në një rast të vetëm, për të cilin do të flasim në një pjesë të këtij punimi, nuk ekziston madje asnjë ndërhyrje më e vogla në përpunimin e fotografisë. Siç edhe mund të shihet në fotografinë⁹ në vend të editorialit,

si pjesë e një reagimi të bërë pas deklaratave të pamatura dhe skandaloze të Jiri Dienstbier, i dërguar special i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut për Ballkan, një dromçë e të bërave të makinerisë vrastare serbe është prezantuar përmes tri fotografive, pa intervenuar në asnjërin prej tyre, arrihet qartë dhe saktë të përcillet mesazhi si protestë, dhe të thuhet saktësisht ajo që është synuar me atë rast, por gjithnjë, duke pasur parasysh faktin se e vërteta (në këtë kuadër, pra as fotografia me pamje nga një ngjarje) nuk duhet të retushohet, si dhe nuk mund të bëhet lojë me viktimat e krimin. Kjo më së miri ilustron në fotografinë e mesit, të dytën pra, e cila është bërë ashtu që flet mjaft mbi barbaritë serbe gjatë luftës së Kosovës, por që fytyrat e viktimave, megjithatë, nuk fokusohen sikur që nuk fokusohen as pjesët e tjera (të gjymtuara) të trupit të viktimave.

Ajo që mund të dalë nga kjo është se ishte qëndrim i redaksisë së revistës "Kombi", që gazetarët e saj të arrinin çdo kund ku ishte e mundshme të arrihej në rrethana të luftës, që të fotografohej gjithçka - çdo viktimë, çdo njeri i zhvendosur, çdo kokë bagëtie e vranë apo çdo godinë e bombarduar apo e djegur. Por, parimet e vërtetësisë duhej që t'i respektonim deri në fund, pa marrë parasysh dëshirën për të qenë i pari me një informatë, apo që ta përcjellim të vërtetën deri te publiku mbi atë që po ndodhte apo, në fund të fundit, edhe për t'i shënuar faqet e historisë përmes fotografive.

Përvojat e fotografetarëve të luftës

Edhe pse, nga sa u tha më lart, shihet se përkushtimi i redaksisë së revistës "Kombi" dhe i gazetarëve të saj ishte që para opinionit të plasnin vetëm të vërtetën, megjithatë kjo nuk do të thotë se nuk kishte dilema të kohëpaskohshme mbi atë se çfarë duhet të fotografohet dhe çfarë të përzgjidhet për botim. Gazetari Emin Emini, mes të



Rëndësia e fotografetarisë

Fotogazetaria çdoherë e më shumë po bëhet videograf, sepse një ngjarje regjistrohet përmes fotografive dhe janë pikërisht fotografitë të cilat e bëjnë apo e shkatërrojnë një gazetar apo revistë. Detyrë e fotografetarisë është që të mësohet e vërteta, e vërtetë kjo të cilin që të dyja palët duan ta përvetësojnë, por që mund të bëhet publike vetëm përmes gazetarisë së paanshme, ashtu që lexuesi mund vetë të gjejë se cila është e vërteta.

Etika dhe fotografetaria

Ideja e fotografetarisë si profesion është e vjetër vetëm disa dekada. Prandaj dhe është përmendur fare pak mbi etikën e fotografetarisë në librat të cilat iu dedikohen studentëve të gazetarisë. Në të vërtetë, gjatë gjithë periudhës së botimit të teksteve për gazetari,

kur marrin pamje nga një vendngjarje, gjatë një interviste, në një reportazh, sepse një pakujdesi e vogël mund të shkatërrojë gjithçka. Në këtë kontekst duhet të përmendet edhe një autor tjetër, Wilson Hicks, i cili shumë vite më vonë, në librin *Fjalët dhe fotografitë*, insiston se fotografët dhe fotografitë duhet të kenë po të njëjtin respekt si fjalët dhe shkrimtarët, edhe pse në një pjesë të librit, ku flet për etikën në fotografetari, thotë se ka disa situata në të cilat "mbindërtimi, riaranzhimi dhe udhëzimi janë të nevojshme"⁴, gjë e cila sot edhe mund të konsiderohet si joetike dhe mund të sjellë deri te diskutimet e shumta.

Mirëpo, mbi dhunimin e etikës dhe gazetarisë, edhe përkundër shumë debateve dhe diskutimeve, mbetet akoma për t'u thënë, ndërsa në këtë punim do të ndalemi në disa prej shembujve të cilët mund të gjenden edhe në fotografetarinë botërore. Në këtë kontekst mund të përmendim



ËS NË REVISTËN KOMB

tjerave, thotë se “kisha shpesh dilema etike mbi atë se a duhet ta fotografojë një imazh dhe nëse po, a duhet patjetër ta bëjë publike? Ishte e vështirë sepse në faqet e revistës së vetme që sillte pamje dhe rrëfime autentike nga tërë Kosova e përfshirë në flakë, po shkruhej historia. Në histori ishin edhe ato fotografi tronditëse si kjo e Reçakut¹⁰, pas publikimit të të cilave u ngrë e gjithë bota demokratike në këmbë për ta ndaluar terrorin, apo jo?”¹¹

Ndërsa gazetarja e kësaj reviste, Donikë Shahini, ende jeton çastet e udhëtimeve të saj anakënd trevave shqiptare në kërkim të lajmit dhe për t'i mbështetur deklaratat e shumta politike mbi terrorin që po ushtrohej mbi popullatën shqiptare. “Ndonjëherë dhe ishte e vështirë të mendoj se duhet ta marr mbi vete përgjegjësinë për

foajeun e Parlamentit Evropian, në ekspozitën e fotografive të Haqif Mulliqit të hapur më 29 maj 1998. Në lidhje me këtë ekspozitë, në një bisedë me gazetaren Donikë Shahinin Jaak Vandemeulebrck, deputet i Parlamentit Evropian, do të deklarojë se “mezi priste që të hapej kjo ekspozitë, sepse anëtarët e Parlamentit do të mund të shihnin çfarë ka bërë regjimi serb në Kosovë”.¹³ Më poshtë, po në të njëjtën intervistë Vandemeulebrck do të shtojë:


“Kur e pamë këtë ekspozitë të zotit Haqif Mulliqi, si dhe ia lexuam reportazhet nga vendluftimet me plot deklarata dhe rrëfime rrëqethëse që shpijnë deri në trishtim, atëherë më duket se të gjithë anëtarët e Parlamentit sikur krijuan një bindje tjetër për shqiptarët e Kosovës si dhe për gjithë atë që ndodhte atje”.¹⁴

shumë ekskluziv: “Rrëfimi i luftëtarit të lirisë, Hamëz Jashari nga Prekazi i Ulët”.¹⁵ Titulli i këtij shkrimi ishte: “Terrorist është ai që sulmon të vrasë e jo ai që mbrohet. Ne vetëm mbrojtëm pragun tonë nga një sulm terrorist”.¹⁶

Mbase e veçantë tjetër e këtij reportazhi është edhe fakti se në këtë artikull të gjatë sillen edhe fotografi ekskluzive të pikave prej nga kanë qëlluar snajperët serbë gjatë sulmit të 22 janarit, si dhe mure të goditura nga predhat dhe projektilet e armëve të terroristëve serbë që sulmuan këtë familje.¹⁷ Po ashtu, është e një rëndësie të veçantë, do të thoshim, edhe fotografia në të cilën shihen fotografat e “Kombit” (autorja e këtij punimi) dhe Minire Fetahu me Selvete Hamëz Jashari e plagosur në këtë sulm dhe e vrarë vetëm pas pak javësh në sulmin e tretë të forcave terroriste serbe, dhe me Iliriana Rifat Jasharin. Mendojmë se kjo fotografi edhe si e këtyllë e ka vlerën e saj ngaqë besojmë se kjo do të ketë qenë fotografia e fundit e Selvete Jasharit, e cila, pa e shëruar mirë plagën e parë, u vra nga forcat serbe. Ndoshta edhe më i rëndësishëm mund të gjykohej fakti tjetër se këtë fotografi¹⁸ e ka realizuar heroi i kombit Hamëz Jashari.

Se sa kanë punuar në terren fotogazetarët e “Kombit” dhe se cili do të jetë roli i tyre për prezantimin e historisë së luftës së Kosovës, mbase çdo lexues i vëmendshëm i kësaj reviste në atë kohë (ndërsa lexuesit ishin të shumtë ngaqë revista arrinte tirazh marramendës për kohën deri në 80 mijë kopje¹⁹) ka mundur ta paramendojë, mbase që nga numri i gjashtë i kësaj reviste i cili doli në shitje pak ditë pas ngjarjeve të 5 dhe 6 marsit në Prekaz. Në fakt, në këtë kohë, që nga data 5 mars në Prekaz, bashkë me disa prej luftëtarëve të orëve të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të qëndrojnë kryeredaktori i revistës, Haqif Mulliqi²⁰, i cili para opinionit publik të Kosovës solli një numër jashtëzakonisht të madh të fotografive të cilat e dokumentonin luftën heroike të Jasharëve, por edhe shkallën e terrorit serb, në një aksion që kishte për qëllim t'i paraprinte fushatës tjetër ushtarake kundër Drenicës dhe pjesës së Kosovës që kufizohej me të: Llapush, Ortakoll etj. Madje, që në ballinë të numrit 6 të “Kombit”, lexuesi, përmes fotografive që flasin shumë, do të ketë mundësi të depërtojë në realitetin e asaj që po ndodhte atje.

Në faqet vijuese të revistës, “Kombi”²¹, bashkë me rrëfimet e familjarëve dhe dëshmitarëve të ngjarjes së 5, 6 dhe 7 marsit të 1998-s (Bahtije Jasharit, Agron Jasharit, Naile Jasharit, Syleme Jasharit, Sevdie Jasharit, Sala Jasharit dhe Artan Jasharit)²², sjell edhe pamje



Gazetaret e revistës “Kombi”. Fotografi e realizuar nga Hamëz Jashari

përzgjedhjen e imazheve të cilat do ta ilustronin shkrimin. Ajo që nuk diskutohej fare ishte fakti se secili gazetar i ‘Kombit’ kishte për obligim të fotografohej në vendin e ngjarjes dhe me personazhet të cilat intervistoheshin sepse ishte edhe kjo që na dallonte nga të tjerët të cilët shkrimet dhe fotografitë e publikuara i huazonin nga agjencitë e huaja të lajmeve sikur të mos ishin nga Kosova!¹²!”

Këtu duhet pasur parasysh edhe një fakt se fotoreporterët e agjencive të ndryshme të lajmeve së pari asnjëherë nuk shkolin në zona ku kishte veprime luftarake, por edhe nëse ndonjëherë situata mund t'i gjente në një zonë të “nxehtë”, ata nuk e gëzonin besimin e luftëtarëve guerilë shqiptarë sepse gjithmonë ekzistonte mundësia që ndonjëri prej reporterëve të huaj të punonte për një apo më shumë shërbime të inteligjencës dhe fotografitë mund të arrinin edhe në duar të shërbimit serb të inteligjencës.

Janë me qindra filma të zhvilluar nga pronari i “Foto Nikon”, Isë Hetemi, që nuk janë botuar në faqet e revistës “Kombi” por që, në fakt, kanë lënë shenjë në historinë e re për faktin se janë ekspozuar në

Fotografitë e revistës “Kombi” të cilat e shënuan historinë e luftës së Kosovës

Puna e fotogazetarëve të revistës “Kombi” kishte edhe çaste të tilla ku fotografitë dhe shkrimet të cilat bëheshin për këtë revistë ishin të parat që shënonin ngjarjet e një rëndësie të veçantë për historinë kombëtare. Madje, ndonjëherë, për fat të keq, ato jo vetëm që shënuan të parat një ngjarje, duke e krijuar edhe një vizion për to por, fatqësisht, doli të ishin edhe fotografitë e fundit të personazheve që kishin një domethënie për një ngjarje të caktuar, për luftën e Kosovës, apo edhe për historinë tonë kombëtare në përgjithësi. Të këtylla janë, ta themi, fotografitë e Hamëz Jasharit, i cili (kam nderin ta them edhe me këtë rast) autores së këtij punimi i krijoi mundësinë e papërsëritshme që ta bëjë intervistën e vetme që kanë dhënë ndonjëherë vëllezërit Hamëz dhe Adem Jashari. Në fakt, intervista fillimisht ishte botuar brenda një reportazhi të gjatë, i cili kishte të bënte me sulmin e 22 janarit mbi familjen Jashari, me mbititullin

të familjarëve të terrorizuar të Jasharëve që ia kishin dalë ta shpërthenin rrethimin dhe ishin vendosur në fshatin Ashlan.²³

Mendojmë se është e një rëndësie të veçantë ta sjellim në këtë pjesë deklaratën e H. Mulliqit mbi atë se përse “Kombi” ishte, të thuash, e vetnja revistë apo gazetë shqiptare që botohej në Kosovë, e cila nuk i publikoi fotografitë e komandantit legjendar Adem Jasharit dhe Jasharëve të tjerë të vrarë: “Thjesht”, thotë ai, “ne e kishim bërë një vlerësim në redaksi bashkë me Haki Mulliqin, Emin Eminin, Milazim Krasniqin, Shpresë Mulliqin, Donikë Shahinin, Musa Kurhaskun, Skënder Sadikun etj.) dhe e kishim marrë një si vendim që fotografitë e të vrarëve të mos botoheshin për dy arsye. E para, lufta kishte marrë hov dhe nuk donim që pamje të tilla të kishin ndikim psikologjik të njerëzit të cilët ishin të gatshëm të shkonin në luftë dhe të vetëmohoheshin. Dhe, e dyta, ne nuk kishim dëshirë që publikut t'i shërbenim para fotografitë e luftëtarëve siç ishin Ademi dhe Hamza. Ata, në Drenicë dhe rreth saj, ishin ngritur në mite dhe legjenda dhe ne nuk donim që përmes fotove t'i shpërftyronim dhe ta thyenim atë mit. Personalisht mendoj se Beogradi ishte i interesuar ta thyente mitin për Hamëz dhe Adem Jasharin dhe ta minimizonte luftën e tyre titanike, të Davidit kundër Goliatit”.²⁴ Fotografitë e Jasharëve

të vrarë, të ekspozuar në oborrin e një shitoreje të materialit ndërtimor në Tushillë të Skenderajt, që i kishim ne, i ka bërë Bekim Shyti.²⁵

Vjton

¹ Caroline Brothers, *War and Photography, a cultural history*, Routledge, 1995, f. 11

² John Tagg (1988: 65)

³ Albert Frederick Henning, *Ethics and practices in journalism*, New York, R. Long & R. R. Smith, inc., 1932

⁴ Po aty

⁵ Revista Times, 150 vjet të fotogazetarisë, 1989, f. 4

⁶ Paul Martin Lester, *Fotogazetaria një qasje etike*, kapitulli i gjashtë *Manipulimi i fotografive*:

<http://commfaculty.fullerton.edu/lester/writings/chapter6.html>, shikuar me 21.06.2009

⁷ Wikipedia: Biografia e Alexander Gardner, [http://en.wikipedia.org/wiki/Alexander_Gardner_\(photographer\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Alexander_Gardner_(photographer)), shikuar me 21.06.2009

⁸ Kodi i Etikës, uebfaqja e Shoqatës së Fotogazetarëve,

http://www.nppa.org/professional_development/business_practices/ethics.html, shikuar me datën 21.03.2019

⁹ *Kombi*, datë 28 tetor 1998, f. 2

¹⁰ *Kombi*, nr. 16, datë 27 janar 1999, f. 15

¹¹ Emin Eminin, intervistë dhënë enkas për këtë punim

¹² Po aty

¹³ *Kombi*, nr. 11, datë 15.06.1998, f. 18

¹⁴ Po aty

¹⁵ Ballina e revistës *Kombi*, nr. 4, dt. 02.02.1998

¹⁶ *Kombi*, nr. 4, fq. 11

¹⁷ *Kombi*, nr. 5, f. 12 dhe 13

¹⁸ *Kombi*, nr. 4, dt. 02.02.1998, f. 12

¹⁹ Konfirmim i këtij tirazhi nga ana e drejtorit të revistës *Kombi*, Haki Mulliqi

²⁰ *Gjashhtë rrathët e tmershëm të ferrit serb*, *Kombi*, nr. 6, f. 8 dhe 9, datë 13 mars 1998

²¹ *Kombi*, nr. 6, datë 13 mars 1998, f. 10, 11 dhe 12

²² Po aty

²³ Po aty

²⁴ Bekim Shyti, komandant i Njësisë Speciale të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Shalës, ndërsa në pjesën e fundit të luftës, pas ristrukturimit të UÇK-së, komandant i Gardës së UÇK-së në ZOSH



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Statujë bronzi për Majlindën, mbështetet vendimi i IJF-së

Vendimi i presidentit të Federatës Botërore të Xhudos, Marius Vizer, që për kampionin olimpik Majlinda Kelmendi të punohet një statujë prej bronzi është mirëpritur dhe mbështetur fuqishëm nga Ministria e Sportit dhe Komiteti Olimpik i Kosovës. Pas këtij lajmi trajneri Driton Kuka po kërkon një vend të përshtatshëm për vendosjen e kësaj statuje

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 19 KORRIK - Sportistes më të mirë shqiptare dhe krenarisë së shtetit të Kosovës, Majlinda Kelmendi, do t'i punohet një statujë prej bronzi. Kështu ka vendosur presidenti i Federatës Botërore të Xhudos, Marius Vizer. Ndërsa lajmin e ka bërë publik trajneri i Majlindës, Driton Kuka. Ky i fundit nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka bërë me dije se po kërkon hapësirën e duhur për ta vendosur këtë statujë. "Federata Botërore e Xhudos, gjegjësisht presidenti Vizer ka vendosur që për Majlindën t'i angazhojë artistët më të njohur në botë për ta punuar statujën prej bronzi për kampionen tonë olimpikë. Çdo gjë do të kryhet sa i përket anës financiare nga Federata Botërore, kurse unë po kërkoj mendime të hapura ku të vendoset statuja, ndonjë vend meritore në vendin tonë. Shpresoj që për Majlindën të ndahet një vend meritore dhe i duhur për kryeveprën që do të vijë nga Nju Jorku së shpejti", ka shkruar Kukan në "Facebook". Ndërsa ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, e ka mirëpritur vendimin e Federatës Ndërkombëtare të Xhudos për ta nderuar me statujë bronzi sportisten Majlinda Kelmendi. "Është lajm shumë i mirë vendimi nga Federata Ndërkombëtare e Xhudos, për ta nderuar me statujë bronzi ikonën e xhudos kosovare dhe ndërkombëtare, Majlinda Kelmendi. Si ministër, e mirëpres bashkëpunimin me Majlinda Kelmendin dhe Driton Kukën si dhe me autoritetet qendrore e lokale për ta përcaktuar vendin e përshtatshëm për vendosjen e statujës", ka thënë Gashi.



Numri një i sportit në Kosovë e ka falënderuar Marius Vizer për këtë vendim, njëherësh e ka përgëzuar Majlinda Kelmendin dhe trajnerin Driton Kuka. "Dua t'i falënderoj drejtuesit e IJF-së në krye me Marius Vizer për këtë vendim të qëlluar dhe i përgëzoj Majlindën, Dritonin dhe tërë ekipin e tij për këtë mirënjohje nga IJF-ja, një dëshmi kjo për suksesin, arritjet e traditën tashmë të krijuar të

xhudos në Kosovë", ka shtuar Gashi. Këtë vendim të Federatës Botërore të Xhudos e ka mirëpritur dhe mbështetur edhe Komiteti Olimpik i Kosovës. "Komiteti Olimpik i Kosovës e mirëpret dhe e mbështet vendimin e Federatës Botërore të Xhudos, duke e vlerësuar hap tejet të qëlluar nga ana e presidentit Vizer, i cili njihet si mik i madh i Kosovës", thuhet në njoftimin e KOK-ut.

SHKURT

Më 24 korrik përballen Slovan Bratislava - Feronikeli

UEFA ka ndryshuar orarin e të dy ndeshjeve të skuadrës së Feronikelit kundër ekipit slovak Slovan Bratislava në kuadër të Ligës së Evropës. Ndeshjen e parë Feronikeli do ta luajë në Bratislavë më 24 korrik, në orën 18:00, ndërsa ajo e kthimit do të zhvillohet pas një jave, saktësisht më 30 korrik, prej orës 18:00 në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

Selimaj përforcon Flamurtarin

Skuadra e Flamurtarit nga Prishtina është përforcuar me portierin Erind Selimaj. Ky i fundit ka qenë pjesë e KF Vllaznia nga Shkodran. Portieri shkodran vlerësohet si një përforcim për skuadrën kuqezi, e cila bën pjesë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll.

'Dardanët' sot përballen me Luksemburgun

Pas përfundimit të grupeve në Kampionatin Evropian, Divizioni B, në Portugali, tashmë fillon faza tjetër e kësaj gare. Kosova U-20 (M), që u rendit e pesta në grup, do të luajë të shtunën ndaj Luksemburgut për pozitat 17-21. Ndeshja fillon nga ora 19:30, kurse të dielën përfundon Kampionati në Portugali. "Dardanët" kanë një fitore ndaj Armenisë.

Kukësi shkarkon trajnerin Gjoka

Skuadra e Kukësit e ka shkarkuar trajnerin Ernest Gjoka vetëm një ditë pas eliminimit nga Liga e Evropës. "Klubi ynë trajnerit Gjoka i ka dhënë gjithë mbështetjen e mundshme, sidomos pas rikthimit të tij në krye të bankinës së skuadrës nënkampione të Shqipërisë. FK Kukësi falënderon trajnerin Gjoka për punën e bërë në krye të ekipit. Shumë shpejt klubi do të njoftojë për emrin e trajnerit të ri, i cili objektiv kryesor do ta ketë fitimin e titullit kampion, Kupës së Shqipërisë si dhe përfaqësim sa më dinjitoz në Kupat e Evropës!", thuhet në njoftimin e FK Kukësi.

Pogba pranon ofertën e Realit

MADRID, 19 KORRIK - Real Madridi ka edhe një objektivi këtë afat kalimtar dhe ai është Paul Pogba. "Operacioni 200" është operacioni i rikrijimit të një Reali me emra të rinj ku deri tani janë bashkuar, Hazard, Joviq, Mendy. Por për të mos rrezikuar me "fair-play"

financiar Real do t'i largojë disa nga yjet e tij nga ekipi. Gareth Bale dhe James Rodriguez janë dy futbollistët që, siç duket, i kanë biletat e prera. Uellsiani duket pranë një kalimi te Bayern Munchen, por pista të mundshme janë edhe Manchester Unitedi si

dhe rikthimi te Tottenhami. Ndërsa kolumbiani James duket shumë afër kalimit te Napoli. Mediat spanjolle bëjnë me dije se Pogba Pogba ka zgjedhur Realin dhe menaxheri i tij Mino Raiola ka refuzuar takimet me drejtuesit e Juventusit.



Shefi i Mercedesit: Sukseset e Schumacherit janë arritur në një nivel krejt tjetër

BERLIN, 19 KORRIK - Objektivi i Lewis Hamiltonit është t'i arrijë rekordet e Michael Schumacherit, por për shefin e Mercedesit, Toto Wolff, kjo gjë është e pamundur.

Piloti britanik ka korrur 80 fitore në Formula 1 dhe është 11 fitore larg legjendës Michael Schumacher. Gjithsesi, ish-piloti i Ferrarit numëron 7 tituj kam-


pionë bote në Formula 1, dy më shumë se Hamiltoni. "Nëse një pilot ka talent, nëse punon fort, ashtu sikurse Hamiltoni dhe ndodhet në një makinë që në ato momente është më e mira, natyrisht se mund të triumfojë gjithnjë. Gjithsesi, ajo që ka arritur Michaeli është ende maksimumi. Ato rezultate janë arritur në një nivel krejt tjetër nga ky që

është sot në sportin tonë", ka thënë Wolff. "Nuk do të jetë e lehtë, por Lewis është në rrugën e duhur. Ai ka ende shumë fitore përpara dhe tituj për të fituar për t'u barazuar me Schumacherin", u shpreh shefi i makinës gjermane. Hamiltoni mban sot rekordin e "pole position", 86, askush si ai në Formula 1 (Schumacher ka arritur 68 pole).



Kloppi: Nuk largohem para kontratës

LIVERPOOL, 19 KORRIK - Trajneri Jurgen Klopp pa dyshim se është një nga trajnerët më të mirë në qarkullim. Sezonin që lamë pas me Liverpoolin ai u shpall kampion Evrope dhe ka ndër-tuar një ekip të admirueshëm. Gjermani ka një marrëdhënie shumë të mirë me tifozët dhe në 2016-n, kur u bë pjesë e Liverpoolit, nënshkroi një kontratë deri në vitin 2021. Vitet kaluan dhe në kampin e të kuqeve po mendojnë për një rinovim të kontratës. Kloppi duke folur për mediet, nuk e konfirmoi faktin se mund ta rinovojë kontratën, por e la të hapur si mundësi. "Nuk e imagjinoj dot se një ditë nuk do të jem trajner i Liverpoolit. Por, më e rëndësishme është të mos gjendem në një situatë ku tifozëve do t'u kthehem si i mërzitshëm, për faktin se akoma nuk jam larguar. Kjo është e vërtetë sepse në futboll këto situata përsëriten. Duhet të jesh gjithmonë në një situatë ku nuk humbet. Mua më pëlqejnë drejtuesit, atyre iu pëlqen puna ime dhe kështu kemi shumë kohë për të menduar për rinovim. Unë nuk dua të largohem para kontratës", ka thënë Kloppi.



Joshua: Do të rikthehem kampion i botës

LONDËR, 19 KORRIK - Boksieri britanik Anthony Joshua (22 fitore dhe 1 humbje në karrierë) premtoi se do të rikthehet kampion i botës në peshat e rënda në boks, pasi do ta kërkojë revanshin ndaj mexikani Andy Ruiz Jr (33 fitore e 1 humbje në karrierë). Kjo sfidë e dytë mes tyre do të zhvillohet në nëntor ose dhjetor të këtij viti, por ende nuk është përcaktuar data e saktë dhe vendi. "Jam gati për ta zhvilluar revanshin dhe jo vetëm kaq, por edhe të rikthehem kampion i botës. Dështimi i parë tashmë është lënë pas krahëve. Nuk jam nga ata që tërhiqem përballë vështirësisë së parë. E ndiej se tani jam sërish gati, ndaj e kërkoj me çdo kusht këtë revansh. Ambicia ime në boks për momentin është të rikthehem sërish kampion bote", ka thënë Joshua.

Sfida e parë mes dy boksierëve u zhvillua në Nju Jork më 1 qershor, me Ruiz që triumfoi me "KO teknik" në raundin e shtatë, duke rëmbyer titujt kampionë bote në peshën e



rëndë në kategoritë IBE, WBA dhe WBO. Kjo ishte sfida e parë e Joshuas në Nju Jork, ku pësoi edhe

humbjen e parë në karrierë dhe kërkon që revanshin ta zhvillojë në Britaninë e Madhe.

SHKURT

De Ligt: Ja pse e zgjodha Juven para Barçës dhe PSG-së

Matthijs De Ligt është prezantuar lojtar i Juventusit. Ai ka treguar se pse e zgjodhi "Zonjën e Vjetër" para Barcelonës dhe PSG-së. "Ishte një proces i gjatë, isha duke parë përreth dhe Italia është e njohur për vendin e mbrojtjes. Ishte një sfidë e madhe. Juventus tregoi se besonte në mua dhe ndjenja bëri ndryshimin", ka thënë De Ligt. "Është një hap i madh, i pari jashtë Holandës dhe unë duhet të ambientohem. Shpresoj ta paguaj përzemërsinë e madhe të tifozëve", ka shtuar De Ligt, i cili edhe në skuadrën e re do ta bartë fanellën me numër katër.

Bale larg Realit, afër Bayernit

Largimi i Arjen Robbenit dhe Franck Riberys ka bërë që Bayern Muncheni të mendojë për lojtarët që do t'i zëvendësojnë. Drejtuesit e Bayernit kanë vënë në shënjestër Gareth Balen. As menaxheri i Bale nuk e ka hedhur poshtë një mundësi të tillë. Bale është shumë i pakënaqur në Real Madrid. Minutazhi i ulët, operacionet e shpeshta janë disa nga arsytet që 30-vjeçari kërkon të largohet nga Reali, kurse Bayerni po monitoron situatën dhe së shpejti mund të kemi një ofertë zyrtare. Për futbollistin interesim kanë shfaqur edhe Tottenham Hotspuri dhe Manchester Unitedi.

Dybala, në 'radar' të Unitedit

Manchester Unitedi po planifikon transferimin e yllit të Juventusit, Paulo Dybala. Sipas raportimeve nga 'Gazzetta dello Sport', Unitedi ka nisur kontaktet e para me Dybala, derisa shuma që duhet ta ofrojnë është së paku 80 milionë euro. 25-vjeçari nuk ka shfaqur shenja se dëshiron të largohet, por ai mund t'i bashkohet skuadrës nga "Old Trafford".

Guarin përgatit rikthimin në Itali

Fredy Guarin la Interin në janarin e vitit 2016 dhe u transferua në kampionatin kinez. Mesfushori kolumbian ka ndërprerë pas 3.5 vjetësh bashkëpunimin me Shanghai Shenhua dhe tani është një lojtar i lirë. 100 ndeshje dhe 28 gola janë shifrat kineze të 33-vjeçarit, i cili pritet të rikthehet në Serinë A. Guarin ka qenë pjesë e Interit për katër sezona, ndërsa tani mund të transferohet tek ekipi i Genoas.

Barça synon transferimin e Alabas

Barcelona ka bërë dy transferime të mëdha deri tash për sezonin e ri, Frenkie De Jong nga Ajaxi Antoine Griezmann nga Atletico Madridi. "Mundo Deportivo" raporton se Barcelona ka shfaqur interesim edhe për yllin e Bayern Munchenit, David Alaba. Skuadra nga "Camp Nou" po dëshiron që ta sjellë edhe një lojtar të rëndësishëm si konkurrent për Jordi Alban.



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine
Dragaš/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr.13/439
Më: 18.07.2019
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2019/2020.

1.SHFMU "Restelica"- Restelic (Gjuhë boshnjake)

1. Një mësimdhënëës për Matematikë
2. Një mësimdhënëës për Fizikë (14 orë)
3. Një mësimdhënëës për Kimi (12 orë)
4. Një mësimdhënëës për Gjeografi (13 orë)
5. Një mësimdhënëës për Histori (18 orë)
6. Një mësimdhënëës për Muzikë (14 orë)
7. Një mësimdhënëës për Biologji (14 orë)
8. Tre mësimdhënëës për mësim klasor

2.SHFMU "9 Maji" Rapçë (Gjuhë boshnjake)

1. Një mësimdhënëës për mësim klasor

3.SHFMU "Zenuni" Brod (Gjuhë boshnjake)

1. Një mësimdhënëës për Fizikë- Kimi (16 orë)
2. Një mësimdhënëës për Histori (10 orë)
3. Një mësimdhënëës të gjuhës angleze (15 orë)

4.SHFMU "Svetlost"- Krushevë (Gjuhë boshnjake)

1. Një mësimdhënëës të Historisë
2. Një mësimdhënëës për Kimi
3. Një mësimdhënëës për Gjeografi
4. Një mësimdhënëës për Muzikë
5. Një edukator/e për mësim parafillor
6. Një mësimdhënëës për mësim klasor – Zlipotok

5.SHFMU "Shaban Shabani" – Llopushnik dhe Ulina Kosavë

1. Gjuhë gjermane (13 orë)

6.SHFMU " 28 Nëntori"- Bresanë

1. Një mësimdhënëës për mësim klasor

7.SHFMU " Shaban Shabani" Llopushnik

1. Një mësimdhënëës për mësim klasor – Pllavë (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)

8.SHML "Ruzhdi Berisha" Dragash

Mësimi në gjuhën shqipe

1. Një mësimdhënëës i lëndës së Matematikës (10 orë) - (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)
2. Një mësimdhënëës i lëndës së psikologjis (10) - (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)
3. Një mësimdhënëës për praktikë profesionale në drejtimin e farmacisë (10 orë)

9.Një asistent për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore (për të gjitha shkollat në komunën e Dragashit)

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.);
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj;
- Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës , duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2019, por në varësi të lirimt real të vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë: 18.07.2019
Dragash

Drejtori i DKA-së
MSc. Vloran Cenaj



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/ L -212 të Punës të Republikës së Kosovës dhe shtojcës 1 pika 2 të Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të OSK-së, Oda e Stomatologëve shpall këtë :

**Konkurs Publik
për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta**

Emri i Institucionit:	Oda e Stomatologëve të Kosovës
Titulli i punës:	Zyrtar Ligjor
Koeficienti i pagës:	Me marrëveshje
Raporton te:	Sekretari i Përgjithshëm
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
Numri i ekzekutuesve:	1 (një)
Vendi:	Prishtinë

Detyrat kryesore:

- Harton akte normative si dhe akte tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e OSK-së në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të jetë sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik.
- Ofron shërbime dhe këshilla profesionale për organet e OSK-së sipas kërkesës së organeve të OSK-së dhe referencës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Kryen detyra tjera të caktuara me kontratë

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara për vendin e punës :

- të këtë kryer Fakultetin Juridik;
- 2 (dy) vite përvojë pune në profesion;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punëve.
- Gatishmëri dhe aftësi për të bashkëpunuar dhe për të mbajtur marrëdhënie të mira bashkëpunimi në harmoni ndërkolegiale
- Përvoja e punës është përparësi

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet te: Zyra administrative e OSK-së, rr.Kosta Novakoviç, Kontejneri nr.3, zyra nr. 217.

Kandidatët që paraqitën në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:

Aplikacionin, CV-në, kopjen e diplomës e noterizuar, kopjen e dokumentit identifikues, dëshmitë për përvojën e punës dhe informatat e tjera lidhur me plotësimin e kushteve, të cilat janë të rëndësishme për ata/ato që aplikojnë.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë numër telefoni: 045/240-588, prej orës 8:30 – 15:30, ose email adresën: info@osk-ks.org.

Konkursi mbetet i hapur 7 (shtatë) ditë kalendarike, nga dita e publikimit që nga data: **20.07.2019** deri më **27.07.2019**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin dhe dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në intervistë.



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/ L -212 të Punës të Republikës së Kosovës dhe shtojcës 1 pika 6 të Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të OSK-së, Oda e Stomatologëve shpall këtë :

**Konkurs Publik
për Asistente administrative për organet e odës**

Emri i Institucionit:	Oda e Stomatologëve të Kosovës
Titulli i punës:	Asistent/e Administrative për organet e odës
Koeficienti i pagës:	Me marrëveshje
Raporton te:	Sekretari i Përgjithshëm
Lloji i kontratës:	Për kohë të pacaktuar
Numri i ekzekutuesve:	1 (një)
Vendi:	Prishtinë

Detyrat kryesore:

- Ofron asistencë në kryerjen e punëve administrative për nevojat e punëve të Komisioneve të Përhershme të OSK-së;
- Siguron materialet e nevojshme për mbledhjet e Komisioneve të Përhershme;
- Mirëmbanë dosjet e Komisioneve të Përhershme;
- Ndihmon anëtarët e Komisioneve në kontaktet me organet e tjera të OSK-së si dhe palëve të treta
- Kryen edhe punë tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe specifikimeve të përcaktuara me Kontratën e Punës.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara për vendin e punës :

- Ta këtë të kryer shkollën e mesme, përparësi konsiderohet shkollimi superior;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punëve
- Përvoja e punës është përparësi

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet te: Zyra administrative e OSK-së, rr.Kosta Novakoviç, Kontejneri nr.3, zyra nr. 217.

Kandidatët që paraqitën në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:

Aplikacionin, CV-në, kopjen e diplomës e noterizuar, kopjen e dokumentit identifikues, dëshmitë për përvojën e punës dhe informatat e tjera lidhur me plotësimin e kushteve, të cilat janë të rëndësishme për ata/ato që aplikojnë.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë numër telefoni: 045/240-588, prej orës 8:30 – 15:30, ose email adresën: info@osk-ks.org.

Konkursi mbetet i hapur 7 (shtatë) ditë kalendarike, nga dita e publikimit, që nga data: **20.07.2019** deri më **27.07.2019**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin dhe dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në intervistë.



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/ L -212 të Punës të Republikës së Kosovës dhe shtojcës 1 pika 6 të Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të OSK-së, Oda e Stomatologëve shpall këtë :

**Konkurs Publik
për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta**

Emri i Institucionit:	Oda e Stomatologëve të Kosovës
Titulli i punës:	Asistent/e Administrative për organet e odës
Koeficienti i pagës:	Me marrëveshje
Raporton te:	Sekretari i Përgjithshëm
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
Numri i ekzekutuesve:	1 (një)
Vendi:	Prishtinë

Detyrat kryesore:

- Ofron asistencë në kryerjen e punëve administrative për nevojat e punëve të Komisioneve të Përhershme të OSK-së;
- Siguron materialet e nevojshme për mbledhjet e Komisioneve të Përhershme;
- Mirëmbanë dosjet e Komisioneve të Përhershme;
- Ndihmon anëtarët e Komisioneve në kontaktet me organet e tjera të OSK-së si dhe palëve të treta
- Kryen edhe punë tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe specifikimeve të përcaktuara me Kontratën e Punës.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara për vendin e punës :

- Ta këtë të kryer shkollën e mesme, përparësi konsiderohet shkollimi superior;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punëve
- Përvoja e punës është përparësi

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet te: Zyra administrative e OSK-së, rr.Kosta Novakoviç, Kontejneri nr.3, zyra nr. 217.

Kandidatët që paraqitën në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:

Aplikacionin, CV-në, kopjen e diplomës e noterizuar, kopjen e dokumentit identifikues, dëshmitë për përvojën e punës dhe informatat e tjera lidhur me plotësimin e kushteve, të cilat janë të rëndësishme për ata/ato që aplikojnë.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë numër telefoni: 045/240-588, prej orës 8:30 – 15:30, ose email adresën: info@osk-ks.org.

Konkursi mbetet i hapur 7 (shtatë) ditë kalendarike, nga dita e publikimit, që nga data: **20.07.2019** deri më **27.07.2019**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin dhe dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në intervistë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- **Faton Hashani nga Obiliqi shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Gjeveded Doda" Prishtinë.**
- **Sefer Hysen Shyti me nr. personal 1004883213 shpallë të pavlefshme certifikatën e veteranit Invalid të UÇK-së, të lëshuar nga Komisioni Qeveritarë për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit invalidit veteranit pjesëtarit apo të internuarit të luftës së UÇK-së.**
- **Dekoral Aluminyum San Va Tic A.S- Kosovo Branch dega në Kosovë shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70882086 me nr fis. 600865680**
- **Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188**
- **Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275**
- **Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139**
- **Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.**
- **Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irro 044/672-439.**
- **Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.**
- **Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.**
- **Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.**
- **Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.**
- **Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.**
- **Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.**
- **Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)**

KONKURS

EDUKIDS NË FERIZAJ, SHPALL KONKURS:

- Edukatore - 3 vende të lira;
- Motër Edukatore - 3 vende të lira;
- Kuzhinierë - 1 vend i lirë;
- Pastruese - 1 vend i lirë.

Për të qenë pjesë e EduKids në Ferizaj, ju duhet t'i plotësoni këto kushte dhe kritere:

- Edukatore dhe motër edukatore
Të keni të kryer Fakultetin e Edukimit (Drejtimi Parashkollor, Pedagogji);
Të keni të kryer Shkollën e mesme të mjekësisë - Drejtimi i Përgjithshëm;
Drejtimi i Pediatrisë; Drejtimi Mamisë ose edhe Fakultetin e Mjekësisë - Drejtimi Infjermeri (vlen vetëm për motër edukatore);
Përvojë pune;
Të keni aftësi të shkëlqyera komunikative për të krijuar raporte ndërpersonale me fëmijët;
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar, energjikë dhe emocionalisht të gatshëm për t'u përballuar me situata emergjente;
Të njihni mirë psikologjinë dhe botëkuptimin e fëmijeve;
Të jepni ndihmën e parë në rastet emergjente.

• Kuzhinierë

- Të keni të përfunduar shkollimin e mesëm si dhe përvojë pune së paku 2 vite;
Të keni aftësi të shkëlqyera komunikative për të krijuar raporte ndërpersonale me stafin dhe fëmijët;
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar dhe energjikë.

• Pastruese

- Të keni të përfunduar shkollimin e mesëm si dhe përvojë pune së paku 2 vite;
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar dhe energjikë.

Kandidatet e interesuara duhet të kompletojnë dokumentet:

- CV;
- Diploma dhe çertifikatat e trajnimeve (nëse keni);
- Dëshmitë mbi punët paraprake (nëse keni punuar më herët);
- Çertifikata e lindjes.

Të gjitha këto dokumente duhet të dërgohen në adresën: edukids05@gmail.com
Për info shtesë, kontaktoni EduKids +383 45 714 713 (viber&whatsApp)
KONKURSI MBETET I HAPUR DERI MË 31 KORRIK 2019

Vetëm kandidatet e kualifikuara do të ftohen për intervistë



KONKURS

- Edukatore** - 3 vende të lira
- Motër Edukatore** - 3 vende të lira
- Kuzhinierë** - 1 vend i lirë
- Pastruese** - 1 vend i lirë

CV-të e kompletuara me dokumentet e kërkuara të dërgohen në: **edukids05@gmail.com** deri në datën **31 Korrik 2019**

Për info shtesë, kontaktoni: **+383 45 714 713**

